# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com








Viti XXIV - Nr. 7433 E mërkurë 7 Shkurt 2018 **Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)**


Opinioni i Ditës

Nga "DEUTSCHE WELLE"

## Një e çarë e thellë Turqi-Holandë

Ambasadorit holandez i qe refuzuar hyrja në Turqi gjithsesi që nga marsi i vitit 2017. Tërheqja formale e ambasadorit holandez nga Ankaraja, e cila ...


Vijon në faqen 21






Dje në "Project Syndicate"

Nga HAROLD JAMES

## Kërcënimi nga "Bitcoin"

Për sa kohë një monedhë nuk është certifikuar nga një qeveri, ka pak gjasa që ajo të jetë e besueshme. Por kjo nuk do të thotë se ajo nuk mund të bëhet gjë për ...


Vijon në faqen 22





Serbia dhe Mali i Zi, anëtarësim në 2025

# Integrimi pezull, BE: Luftoni krimin dhe korrupsionin, më pas negociatat

Vlahutin: Qeveria dhe opozita të bashkëpunojnë. Johanes Han: Dera mbetet e hapur për Shqipërinë

Nga DARINA TANUSHI

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje, se hapja e negociatave me Bashkimin Evropian është më afër se kurrë. Pas prezantimit të Strategjisë së Zgjerimit të BE drejt Ballkanit nga komisioneri Johannes Hahn dhe shefja e Politikës së Jashtme, Federica Mogherini, ku Shqipëria ...


Në faqet 2-3


KREU I ALUIZNI-t: NDERTIMET ME SHKELJE, PERFITOJNE 30 MIJE FAMILJE

# LAME: SI DO TA MARRIN HIPOTEKEN 1200 PALLATE

Tri rastet e ndërtimeve me probleme, Artan Lame: Procedura për zgjidhjen e konfliktit. Aplikoni për të marrë certifikatën e pronësisë



*(Në foto)* **Drejtori i ALUZINI-t Artan Lame, gjatë takimit të djeshëm me banorët**


Në faqen 7


DESHMIA

## Skandali "CEZ", prokuroria do marrë në pyetje ish-ministrin Ruli


Në faqen 4


HETIMET

## Vrasja e Kasmit, "Kathimerini": U urdhërua nga burgjet greke


Në faqen 9


AKSIONI NE LEZHE

## Sekuestro për 1.4 milionë euro pasuri të bosit të drogës në Itali


Në faqen 12


"VIP PAGES"

## Çiftet që kanë lindur në "Big Brother" në 11 vite spektakël


Suplement


SI TE KONKURRONI



## Administrata, 1070 vende për mësues, inxhinierë dhe ekonomistë


Në faqen 8


Udhëzimi për testin e detyruar në lëndet Gjuhë-Letërsi, Matematikë dhe Anglisht

# Provimet e maturës, zbardhet programi orientues

*Lista e veprave për testin kombëtar të letërsisë. Ushtrimet e gjuhës së huaj*

Nga VOLTIZA DURO

Të gjithë maturantët e vitit mësimor 2017-2018 do të mund të njihen tashmë me programet orientuese mbi provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2018. Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë ka hartuar programet për secilën lëndë që kanë marrë miratimin e janë firmosur nga ministrja Lindita Nikolla. "Gazeta Shqiptare" publikon sot udhëzimet ku do të bazohet provimi kombëtar i Maturës Shtetërore për lëndën Gjuhë ..




Në faqet 10-11

# STRATEGJIA E ZGJERIMIT
## REAGIMET

Qeveria shqiptare mirëpret strategjinë e Komisionit Evropian

# Rama: Negociatat më afër se kurrë
# Bushati: BE të forcojë angazhimin

## Ministri: Shpresojmë që ky vlerësim të mbështetet nga anëtarët e BE



Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje, se hapja e negociatave me Bashkimin Evropian është më afër se kurrë. Pas prezantimit të Strategjisë së Zgjerimit të BE drejt Ballkanit nga komisioneri Johannes Hahn dhe shefja e Politikës së Jashtme, Federica Mogherini, ku Shqipëria dhe Mali i Zi u vlerësuan se i kanë zbatuar 100% politikat e jashtme të caktuara nga BE reagoi kryeministri Edi Rama. Nëpërmjet një postimi në "Facebook", kreu i qeverisë shprehet me tone optimiste. "Mirëpresim çka thuhet për Shqipërinë në strategjinë e BE. Negociatat më afër se kurrë. Pastaj gjithçka do varet nga fuqia e vrapimit tonë' - shkroi ai. Ndërkohë në një reagim të tij, nga Lituania, ku ishte për një vizitë zyrtare, Ministri për Evropën e Punët e Jashtme, Ditmir Bushati u shpreh: "Strategjia e Zgjerimit e Komisionit Evropian dëshmon vëmendjen ndaj Ballkanit Perëndimor, sikundër ofron një listë masash për integrimin dhe transformimin e të gjitha vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian". "Reforma në drejtësi, zë një vend qendror, ku sipas modelit të reformës së thellë e transformuese të Shqipërisë, vendeve të rajonit u rekomandohet një plan konkret hapash dhe masash për përgatitjen e tyre për zbatimin e detyrimeve që burojnë prej anëtarësimit në BE", tha më tej, ministri i Jashtëm. "Mirëpresim vlerësimin e Komisionit Europian dhe gatishmërinë për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë. Ne besojmë që ky vlerësim i Komisionit do të mbështetet njëzëri nga vendet anëtarë të Bashkimit Evropian, si një investim i qëndrueshëm për procesin e pakthyeshëm të reformave në Shqipëri dhe stabilitetin demokratik të rajonit",- nënvizoi Bushati. "Duke pasur parasysh hendekun zhvillimor mes vendeve të rajonit dhe BE-së, mirëpresim që angazhimet e kësaj strategjie të specifikohen më tej me programe e instrumente financiare në mbështetje të infrastrukturës, ndërlidhjes, arsimit e sigurisë energjetike të rajonit tonë. Shpresojmë që Bashkimi Evropian të forcojë angazhimin në rajon e të demonstrojë qartësi strategjike për të transformuar thellësisht dhe këtë pjesë të Evropës",-përfundoi reagimin e tij, ministri Bushati.



Kryeministri Edi Rama

**TAULANT BALLA**

Kryetari i Grupit të PS, Taulant Balla e lexon si inkurajues mesazhin e Vlahutin dhe Hahn për integrimin e Ballkanit në BE. "Shqipëria, Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor të ardhmen e tyre e kanë në BE. Ky është mesazhi i qartë në Strategjinë "Juncker""- shprehet Balla në "Facebook".

**MAJLINDA BREGU**

"Komisioni Europian është gati të përgatisë rekomandimin për çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në rast se kushtet vlerësohen të përmbushura. Për këtë duhet të presim muajin prill. Jo rrallë jemi shpallur problem në Europë. Shpresoj që të gjithë të pranojnë sot se pa Europë s'ka zgjidhje të problemeve. Për më tepër që Europa nuk është shpërblim për politikanët, por detyrim i tyre për qytetarët",-tha dje, ish-ministrja e Integrimit.

### Ambasadorja e BE: Do të monitorojmë ecurinë e reformave

## Vlahutin: Qeveria dhe opozita të punojnë deri në pranverë me konstruktivitet

Ambasadorja e BE në Tiranë, Romana Vlahutin deklaroi dje, gjatë prezantimit të strategjisë së zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor se duhen zbatuar reformat. "Është i nevojshëm dialogu konstruktiv në të gjithë spektrin politik. Qeveria t'i hapë mundësi opozitës dhe kjo e fundit të angazhohet në mënyrë konstruktive. Shpejtësia e anëtarësimit të gjashtë vendeve do të varet nga progresi i gjithsecilit. Shqipëria ka një mundësi reale për të hapur negociatat. Sa më shumë reforma të zbatoni, aq më shpejt do të arrini. Reforma në drejtësi është një punë e bërë përpara. Kështu ju mund të arrini vendet që tashmë i kanë hapur negociatat. Qeveria dhe opozita të punojnë deri në pranverë me konstruktivitet",-u shpreh Vlahutin. Në lidhje me plotësimin e dy institucioneve të rëndësishme KLP-së dhe KLGJ-së, Vlahutin tha: "Ne e kemi parë dhe ndjekur këtë çështje. ONM ka funksione të ndryshme sa i përket zgjedhjes së anëtarëve. Është çështje interpretimi, interpretimi i parlamentit që ka të njëjtën peshë në lidhje me listën. Fatkeqësi është se nuk u bë përpjekje nga partitë politike duke gjetur zgjidhje te merita". Ajo u shpreh se do të ketë monitorim nga BE sidomos për punën e qeverisë.



**PETRIT VASILI**

"Opozita do të mbështesë e do të votojë pa hezitim çdo kandidat që respekton ligjin dhe opinionin e ONM. Maxhoranca po e dhunon hapur edhe ligjin, edhe ONM. Në qoftë se Vlahutin është dakord me këtë që mazhoranca bën, le ta thotë qartë, ndryshe çdo thirrje ndaj opozitës është thjesht alibi për antireformën që zbatohet në drejtësi",-tha dje, kreu i Grupit të LSI.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta me ambasadoren e delegacionit të BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin

## Presidenti merr strategjinë e KE: Të lexohet mirë nga politika shqiptare

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti dje, në një takim ambasadoren e delegacionit të BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin. Ambasadorja Vlahutin i dorëzoi Presidentit Meta strategjinë e re të Komisionit Evropian, "Një perspektivë e besueshme zgjerimi dhe një angazhim i thelluar i BE-së në Ballkanin Perëndimor", si dhe Planin e Veprimit në mbështetje të transformimit të Ballkanit Perëndimor. Presidenti Meta vlerësoi synimin për të pasur një angazhim gjithnjë e më të madh, si nga vendet e rajonit ashtu edhe nga Bashkimi Evropian, në proceset transformuese drejt anëtarësimit të plotë të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Presidenti Meta nënvizoi se strategjia e re e Komisionit Evropian është një dokument që duhet të lexohet me vëmendje nga faktorët politikë shqiptarë për t'u pasqyruar në përpjekjet dhe angazhimet e tyre drejt synimit të përbashkët të integrimit të plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*****, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Dokumenti, KE publikon strategjinë për Ballkanin Perëndimor

# BE përcakton 6 nisma për rajonin, Hahn e Mogherini: Plotësoni reformat

## Shqipëria e Maqedonia po përparojnë, gati të rekomandojmë negociatat



Komisioni Evropian miratoi dje, pas 15 vitesh një strategji të re për 6 vendet e Ballkanit Perëndimor. Viti 2025 mbetet si afat për anëtarësimin, nëse këto vende do të përmbushin kushtet e vëna që kanë të bëjnë me reformat e brendshme, por edhe fqinjësinë. Por, siç deklaruan drejtuesit e lartë të Komisionit Evropian, shefja për Politikën e Jashtme Federica Mogherini dhe komisioneri i zgjerimit Johannes Hahn do të shihet vetëm progresi personal i secilit vend. Në prezantimin e strategjisë për 'Një perspektivë të besueshme zgjerimi dhe rritjen e angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor', u konfirmua fakti që BE e ka derën e hapur për vendet e Ballkanit Perëndimor, gjithsesi. Siç njoftoi Presidenti Juncker në fjalimin e tij mbi gjendjen e BE-së në vitin 2017, Komisioni konfirmoi të ardhmen evropiane të rajonit si një investim gjeostrategjik në një Evropë të qëndrueshme, të fortë dhe të bashkuar, bazuar në vlera të përbashkëta.

Strategjia përcakton përparësitë dhe fushat e bashkëpunimit të përbashkët të përforcuar, duke trajtuar sfidat specifike me të cilat ndeshet Ballkani Perëndimor, në veçanti nevojën për reforma themelore dhe marrëdhënie të fqinjësisë së mirë. Një perspektivë e besueshme zgjerimi kërkon përpjekje të vazhdueshme dhe reforma të pakthyeshme. Progresi në udhën evropiane është një proces objektiv dhe i bazuar në merita që varet nga rezultatet konkrete të arritura nga çdo vend individual. Komisioni Evropian shpalli gjashtë nisma kryesore - masa specifike që BE-ja do t'i ndërmarrë gjatë viteve të ardhshme për të mbështetur përpjekjet për transformim të Ballkanit Perëndimor në fusha me interes të ndërsjellë. Ato shkojnë nga nisma për forcimin e shtetit ligjor, përforcimi i bashkëpunimit për sigurinë dhe migrimin, deri te ekipet e përbashkëta hetimore dhe rojat evropiane kufitare dhe bregdetare, duke e zgjeruar Bashkimin e Energjisë së BE-së në Ballkanin Perëndimor apo duke ulur tarifat roaming dhe duke futur internetit me shpejtësi të lartë në rajon. Strategjia nënvizon, gjithashtu, nevojën që BE-ja të jetë e përgatitur për të mirëpritur anëtarët e rinj pasi të kenë përmbushur kriteret.

Presidenti i Komisionit Evropian Jean-Claude Juncker deklaroi: "Investimi në stabilitetin dhe prosperitetin e Ballkanit Perëndimor nënkupton investim në sigurinë dhe të ardhmen e Bashkimit tonë. Ndonëse nuk do të ketë zgjerime të mëtejshme në këtë mandat, sot Komisioni Evropian po planifikon udhën e ardhshme evropiane për Ballkanin Perëndimor. Me vullnet të fortë politik, me reforma të vërteta dhe të qëndrueshme, si dhe me zgjidhje përfundimtare të mosmarrëveshjeve me fqinjët, vendet e Ballkanit Perëndimor mund të ecin përpara në udhët e tyre përkatëse evropiane. Arritja e kësaj varet nga meritat e tyre objektive. Komisioni Evropian do të jetë rigoroz, por do të jetë edhe i paanshëm. Unë do të udhëtoj në secilin prej vendeve të Ballkanit Perëndimor në fund të këtij muaji me një mesazh të qartë: vazhdoni reformat dhe ne do të vazhdojmë ta mbështesim të ardhmen tuaj evropiane."

Përfaqësuesja e lartë, zëvendës presidentja Federica Mogherini komentoi: "Kjo strategjia tregon udhën që kemi përpara: që të gjashtë partnerët tanë ta kapërcejnë njëherë e përgjithmonë të kaluarën, që të gjithë ne së bashku ta bëjmë procesin e Ballkanit Perëndimor drejt Bashkimit Evropian të pakthyeshëm dhe të vazhdojmë ribashkimin e kontinentit. Kjo Strategji na jep të gjithëve një perspektivë të përbashkët, të qartë, pa ekuivok, të besueshme dhe konkrete për integrimin në BE të secilit prej gjashtë partnerëve tanë. Muajt e ardhshëm do të jenë jo vetëm intensivë, por edhe vendimtarë për të siguruar që kjo mundësi historike dhe unike të shfrytëzohet." "Nuk ka një afat. Ne do të respektojmë atë që kemi thënë. Procesi është i bazuar mbi meritat dhe reformat", tha Mogherini. "Kemi përpara një axhendë intensive. Ky proces bëhet i pakthyeshëm, le ta bëjmë të ndodhë. Mesazhi është le ta bëjmë të ndodhë, le ta sjellim Ballkanin në BE jo në një periudhë të largët",-tha ajo.

Komisioneri për Politikat Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit Johannes Hahn theksoi: "Dera e BE mbetet e hapur dhe do të jetë e hapur. Është një perspektivë që shkon deri në 2025. 6 partnerët tanë në rajon janë pjesë e Europës si gjeografikisht edhe emocionalisht. Procesi i integrimit nuk mund të jetë i kompletuar pa ta". "Ky proces do të varet nga progresi personal i çdo vendi që synon të anëtarësohet. Ballkani duhet urgjentisht të plotësojë prioritet kyçe, sundimin e ligjit, luftën kundër krimit të organizuar, reformat ekonomike",- tha Hahn. Sipas Hahn "Të gjitha çështjet bilaterale duhet të zgjidhen në mënyrë bindëse në mënyrë që të vazhdojnë bisedimet. BE nuk do të pranojë vende me konflikte me fqinjët". "Axhenda 2025 nuk është një target i caktuar, nuk është një datë detyruese. Ajo është skenari më i mirë i mundshëm. Pavarësisht se kemi caktuar një afat kjo nuk do të thotë që do të anëtarësoheni automatikisht, kjo varet nga meritat personale", -tha Hahn.

### DOKUMENTI FOKUS TE REFORMAT BINDËSE DHE PAJTIMI

Për të përmbushur kriteret e anëtarësimit në BE dhe në vetë interesin e tyre, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të zbatojnë reforma gjithëpërfshirëse në fusha vendimtare. Shteti ligjor, të drejtat themelore dhe qeverisja duhet të forcohen ndjeshëm. Reformat gjyqësore, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe reforma e administratës publike duhet të japin rezultate reale dhe funksionimi i institucioneve demokratike duhet forcuar seriozisht. Reformat ekonomike duhen ndjekur me energji në mënyrë që të trajtohen dobësitë strukturore, konkurrenca e ulët dhe normat e larta të papunësisë. Të gjitha vendet duhet të angazhohen pa ekuivok, si me fjalë ashtu edhe me vepra, për të kapërcyer trashëgiminë e së kaluarës, duke arritur pajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve të hapura, në veçanti mosmarrëveshjet kufitare, shumë përpara pranimit në Bashkimin Evropian. Duhet të ekzistojë një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht e detyrueshme normalizimi midis Serbisë dhe Kosovës, në mënyrë që ato të përparojnë në rrugët e tyre përkatëse evropiane.



Shefja për Politikën e Jashtme Federica Mogherini dhe komisioneri i zgjerimit Johannes Hahn

### GJASHTË NISMA KRYESORE PËR TË MBËSHTETUR TRANSFORMIMIN E BALLKANIT PERËNDIMOR

BE-ja tashmë është donatori dhe investitori më i rëndësishëm në rajon, si dhe partneri politik i Ballkanit Perëndimor. BE-ja është, gjithashtu, partneri më i madh tregtar i Ballkanit Perëndimor me një vëllim total vjetor tregtar prej 43 miliardë euro (2016). Sot, Komisioni Evropian përcaktoi gjashtë nisma kryesore që do ta forcojnë më tej bashkëpunimin tonë në një numër fushash dhe do të mbështesin procesin e transformimit në Ballkanin Perëndimor. Këto nisma kryesore synojnë fusha specifike me interes të përbashkët: shteti ligjor, siguria dhe migracioni, zhvillimi social-ekonomik, transporti dhe ndërlidhja e energjisë, agjenda digjitale, pajtimi dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Në këto fusha janë parashikuar veprime konkrete ndërmjet viteve 2018 dhe 2020.

Për të arritur rezultate me Strategjinë e Ballkanit Perëndimor dhe për të mbështetur një tranzicion të qetë drejt anëtarësimit, financimi i mjaftueshëm është i domosdoshëm. Komisioni Evropian propozon rritjen graduale të fondeve në kuadër të Instrumentit të Asistencës para Anëtarësimit (IPA) deri në vitin 2020, për sa kohë e lejojnë rishpërndarjet brenda zarfit ekzistues. Vetëm në vitin 2018, janë parashikuar tashmë 1.07 miliardë Euro asistencë para anëtarësimit për Ballkanin Perëndimor, përveç pothuajse 9 miliardë Eurove nga periudha 2007-2017.

### HAPAT E TJERË NË RRUGËN DREJT BE-SË

Politika e zgjerimit të BE-së duhet të jetë pjesë përbërëse e strategjisë më të madhe për forcimin e Bashkimit Evropian deri në vitin 2025, përcaktuar nga Presidenti Juncker në fjalimin e tij mbi gjendjen e BE-së të shtatorit 2017 dhe në Udhërrëfyesin e tij për një Bashkim Evropian më të bashkuar, më të fortë dhe më demokratik. Ndërkohë që BE-ja mund të zgjerohet me më shumë se 27 anëtarë, dinamikat e ecjes përpara në rrugët e tyre përkatëse drejt BE-së për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor bazohen në meritat dhe shpejtësinë e tyre, në varësi të rezultateve konkrete të arritura. Strategjia shpjegon hapat që duhet të ndërmerren nga Mali i Zi dhe Serbia për të përfunduar procesin e anëtarësimit në një perspektivë të vitit 2025; ndërsa të tjerët mund t'i arrijnë, Mali i Zi dhe Serbia janë të vetmet vende me të cilat bisedimet e anëtarësimit janë tashmë në zhvillim e sipër. Kjo perspektivë në fund do të varet nga vullneti i fortë politik, arritja e reformave të vërteta dhe të qëndrueshme dhe zgjidhjeve përfundimtare për mosmarrëveshjet me fqinjët.

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë mundësinë për të ecur përpara në rrugët e tyre përkatëse evropiane. Komisioni i vlerëson të gjitha vendet në mënyrë të paanshme dhe objektive, në bazë të meritave të tyre dhe shpejtësisë me të cilën arrijnë progres. Shqipëria dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë po bëjnë përparim të rëndësishëm në rrugën e tyre evropiane dhe Komisioni është i gatshëm të përgatisë rekomandime për të hapur negociatat e anëtarësimit, në bazë të kushteve të përmbushura. Komisioni do të fillojë përgatitjen e një opinioni mbi aplikimin për anëtarësim të Bosnje dhe Hercegovinës pas marrjes së përgjigjeve gjithëpërfshirëse dhe të plota për Pyetësorin e tij. Me përpjekje dhe angazhim të qëndrueshëm, Bosnja dhe Hercegovina mund të bëhet vend kandidat për anëtarësim. Kosova ka një mundësi për progres të qëndrueshëm përmes zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim dhe Asocimit dhe për të përparuar në rrugën e saj evropiane, kur ta lejojnë rrethanat objektive.

### ANGAZHIMI POLITIK NGA LIDERËT E RAJONEVE

Shumë punë mbetet për të bërë që vendet e interesuara të jenë në gjendje të përmbushin kushtet dhe kriteret për anëtarësimin në BE. Strategjia thekson se liderët në rajon nuk duhet të lënë asnjë dyshim për orientimin dhe angazhimin e tyre strategjik. Në fund janë ata që duhet të marrin përgjegjësinë për ta bërë realitet këtë mundësi historike.

### PËRGATITJA E BE-SË PËR TË MIRËPRITUR ANËTARËT E RINJ

Vetë BE-ja duhet të jetë gati për anëtarët e rinj të familjes - pasi të kenë përmbushur kushtet - edhe nga perspektiva institucionale dhe financiare. Bashkimi Evropian duhet të jetë më i fortë, më solid dhe më efikas para se të bëhet më i madh. Për të siguruar vendim-marrje efektive, ne duhet të përdorim votimin me shumicë të cilësuar në Këshill në fushat e politikave ku kjo tashmë parashikohet. Përveç kësaj, Komisioni Evropian do të paraqesë mundësitë për të përmirësuar më tej përdorimin e votimit të shumicës së kualifikuar në tremujorin e tretë të vitit 2018 - siç u njoftua nga Presidenti Juncker në fjalimin e tij të vitit 2017 për gjendjen në BE.

Nevojitet gjithashtu një sistem më efikas për të trajtuar kërcënimet sistematike ose shkeljet e shtetit ligjor në çdo shtet anëtar të BE-së, me një iniciativë të Komisionit që pritet në tetor 2018.

Së fundi, duhen bërë marrëveshje të veçanta për të siguruar që shtetet e reja anëtare të mos jenë në gjendje të bllokojnë pranimin e kandidatëve të tjerë të Ballkanit Perëndimor.



**EDUARD KUKAN**

"Procesi bazohet tek merita, por 2025 duhet të jetë një afat realist për vendet të cilat janë në negociata për integrimin në BE, si edhe për ato të cilat sapo kanë nisur negociata. Nuk është proces teknik, por është një proces real i bazuar mbi transformimin. Dyert janë të hapur dhe ne ju duam ju në familjen tonë evropiane. Viti 2018 është viti ku procesi mund të bëhet i pakthyeshëm",-tha eurodeputeti Kukan.



**PPE**

"PPE mbeten të përkushtuara ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor me qëllim që ato të integrohen në familjen e BE-së, por ne, gjithashtu, presim që partnerët tanë të dorëzojnë reformat me të cilat janë angazhuar për të mirën e popullit të tyre dhe të rajonit në tërësi. Për fat të keq, shumë nga udhëheqësit e tanishëm në rajon po marrin një drejtim krejtësisht të ndryshëm nga ai që kërkohet nga BE".

PROTESTA

TAKIMET

Aksioni i opozitës, kreu i PD-së tur takimesh me grupet e interesit

# Basha, thirrje fermerëve: Ejani në Tiranë të bllokojmë qeverinë

## "Do t'ju subvencionojmë, do të mbrojmë prodhimet tuaja"




Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, nisi dje një tur takimesh me grupet e interesit në kuadër të aksionit të opozitës kundër qeverisë "Rama". Z.Basha inkurajoi dje fermerët të protestojnë para Kryeministrisë kundër braktisjes nga qeveria. Z.Basha u takua në Divjakë me fermerë, të cilët u shprehën të revoltuar nga mbetja pa shitur e prodhimeve të tyre. Ata deklaruan se janë mashtruar në fushatë nga kryeministri Rama. "Nuk marrim asnjë subvencion as në naftë, as në fara, as në plehra kimike", u shprehen fermerët e Divjakës. Konkurrenca e pandershme sipas fermerëve nga prodhimet e importit dhe mungesa e mbështetjes së qeverisë ishin të tjera shqetësime të fermerëve, të cilave Basha u dha si zgjidhje programin e Partisë Demokratike për Bujqësinë. Ata i thanë kryetarit Basha se do t'i hedhin në lumë prodhimet e tyre, por kreu i opozitës i nxiti që në vend që të çojnë dem djersen e tyre, të vijnë në Tiranë, të bllokojnë Kryeministrinë. "Duhet të hedhim Ramën në kanal, jo djersën tuaj", u tha Basha fermerëve, të cilët treguan se një javë më parë kryeministri Rama jo vetëm nuk u ka dhënë zgjidhje problemit të shkaktuar nga qeveria e tij, por është tallur me ta. Kreu i opozitës i nxiti fermerët që të mos zgjedhin rrugën më të shkurtër, pranimin e situatës kokulur dhe hedhjen e prodhimeve. Basha tha se rruga e vetme është bashkimi me opozitën në protestë para Kryeministrisë për të larguar qeverinë, që e ka lidhur fatin me një grusht të korruptuarish dhe kriminelësh. Kreu i opozitës bëri të qartë se Shqipëria e ka plotësisht të mundur subvencionimin e fermerëve me të paktën 150 milionë euro në vit, një masë kjo që sipas planit të Partisë Demokratike, bashkë me uljen me 240 lekë për litër të naftës dhe lehtësi të tjera për uljen e taksave, do të ndikojë menjëherë në rimëkëmbjen e fermerëve. Kryetari i PD shprehu bindjen se, "një qeveri që është vënë në shërbim të një grushti njerëzish të korruptuar dhe të lidhur me krimin nuk do t'u shërbejë qytetarëve". Sipas Bashës, me programin e PD-së për mbështetjen me 150 milionë dollarë në vit, fermerët do t'ia dalin të konkurrojnë me importin, të shesin prodhimet në treg dhe të rimëkëmben ekonomikisht. "Do t'ju subvencionojmë, do të mbrojmë prodhimet tuaja", premtoi kreu i PD-së. Në takimet me fermerët e Divjakës, kryedemokrati përsëriti qëndrimin e tij se Rama është vënë në shërbim të një grushti njerëzish, ndaj sipas tij, nuk mund të jetë në shërbim të qytetarit.


Kreu i opozitës, Lulzim Basha, dje në Divjakë

**THIRRJA**
Kreu i opozitës i nxiti fermerët që të mos zgjedhin rrugën më të shkurtër, pranimin e situatës kokulur dhe hedhjen e prodhimeve. Basha tha se rruga e vetme është bashkimi me opozitën në protestë para Kryeministrisë për të larguar qeverinë që e ka lidhur fatin me një grusht të korruptuarish dhe kriminelësh.

**SITUATA**
Deputetja e PD-së, Fatbardha Kadiu, apeloi dje që të lihet mënjanë cinizmi e hipokrizia dhe të luftohet për të zgjidhur situatën alarmante që ka mbërthyer vendin. Kadiu thekson se "lufta e opozitës është me çdo të korruptuar dhe se të gjithë së bashku mund ta zhbëjmë këtë farë të keqe, të degjeneruar, që na rrethon e me cinizëm na tregon sesa të zotë janë".

### U përjashtua nga Kuvendi, deputeti i PD: Ruçi si gardian

## Spaho: Aksioni i opozitës, hapat që do ndjekim kundër qeverisë

Opozita nuk do të ndalë protestat deri në rrëzimin e qeverisë "Rama" dhe krijimin e një qeverie antimafia. Sipas deputetit të PD-së, Edmond Spaho, pjesëmarrja e qytetarëve në marshimin e 27 janarit e rrit përgjegjësinë e opozitës. Spaho tha në studion e "News 24" se aksioni opozitar do të vijojë paralelisht me protestat në rrugë dhe luftën e fortë politike në Kuvend. Teksa është ndalur tek situata e krijuar në Kuvend të enjten e kaluar dhe përjashtimin e tij nga seanca, Spaho deklaroi se kryeparlamentari Ruçi bën rolin e gardianit, duke ndjekur politikën e Ramës. "Aksioni ynë politik do të jetë kombinim i protestave në rrugë, së bashku me luftën e fortë politike në Kuvend. Do të ketë protesta të tjera si ajo e 27 janarit, nuk e kemi përcaktuar ende datën. Intensiteti i protestave do të varet nga zhvillimet politike dhe nga pjesëmarrja. Ne në asnjë rast nuk do lejojmë që të na hiqet e drejta e fjalës. Nëse në çdo rast duhet të marrim lejë nga Ruçi për ato që duam të themi, atëherë do të jemi fiktivë në parlament dhe nuk do të përmbushim rolin tonë", u shpreh deputeti Spaho. Duke u ndalur tek rasti i ekstradimit të Nazer Seitajt në Itali, i ashtuquajturi financieri i Habilajve, deputeti demokrat tha se në seancën parlamentare të radhës është kërkuar interpelancë me ministren e Drejtësisë. Sipas Spahos, këto janë përpjekjet e kryeministrit Rama për të shpëtuar ish-ministrin, Saimir Tahiri. "Këtë të enjte ne kemi kërkuar një interpelancë me ministren e Drejtësisë, pasi e gjykojmë si një nga personat më fajtorë për ekstradimin jashtëligjshëm të Nazer Seitajt. Edhe Prokuroria e Për-gjithshme, Drejtoria e Përgji-thshme e Burgjeve dhe policia janë fajtorë për këtë ekstradim. Duam të hedhim dritë mbi përpjekjet që po bën mazhoranca për ta nxjerrë të pafajshëm Saimir Tahirin. Emërimi i prokurores së përkohshme synonte prishjen e provave që rëndojnë situatën e Tahirit. Po kështu, edhe lëvizjet në prokurori tregojnë për përpjekjet që po bëhen në këtë drejtim", tha Spaho.



### Skandali i CEZ, prokuroria thërret Genc Rulin si dëshmitar. Ja ç'thotë ish-ministri

**TIRANË-** Prokuroria thërret ish-ministrin në qeverinë "Berisha", Genc Ruli për çështjen e CEZ. Burime për "BalkanWeb" bënë me dije se ish-ministri do të pyetet si person që ka dijeni për privatizimin e CEZ. Thirrja për t'u pyetur e Rulit vjen pas vendimit të Gjykatës së Tiranës. Gjykata i la detyrë prokurorisë të marrë në pyetje disa emra, mes tyre edhe djali i ish-kryeministrit, Shkëlzen Berisha. Gazetarja Klodiana Lala tha se prokuroria pretendon se Genc Ruli ka njohje me Nuel Kalaj, që konsiderohet i përfshirë dhe se ka përfituar miliona nga privatizimi i CEZ. Fillimisht u tha se ishte vendosur ora 18:00 që Ruli të jepte shpjegimet e tij. Por ish-ministri i kontaktuar nga News24 tha se nuk ka konfirmim zyrtar lidhur me orarin se kur do të paraqitet dhe se pret konfirmim për orarin. "Do jap sqarimet për çështjen në fjalë", tha Ruli. Zoti Ruli ka mohuar që do kalojë pragun e prokurorisë së Tiranës sot. Ai ka qenë Ministër i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës nga viti 2005 deri në vitin 2009.



### Sherr në Kuvend e komisione, por PD dhe PS bëhen bashkë në Uashington

Në seancat e Kuvendit, por edhe komisionet parlamentare, deputetët e PD dhe PS-së nuk ndajnë qëndrime të njëjta. Madje, opozitarët edhe kanë bojkotuar e protestuar para foltores, por kur vjen puna tek ftesat e SHBA-ve, ata bëhen bashkë. Kështu, deputetja e PS, Elona Gjebrea dhe opozitarët Fatmir Mediu dhe Aldo Bumçi i janë bashkuar ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri gjatë një vizite që po zhvillon në Uashington. Ata morën pjesë në një forum të organizuar në Senatin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me temë diskutimi çështjet e sigurisë dhe perspektivën integruese të vendeve të Evropës Juglindore. Të pranishëm në forum ishin senatorë, kongresmenë dhe përfaqësues të vendeve të Evropës Juglindore, të cilët shkëmbyen pikëpamjet për sfidat me të cilat përballet ky rajon.




**MANDATET**

"Djegia e mandateve do të thotë që të jemi një hap larg konfliktit civil. Në bazë të djegies së mandateve të deputetëve, nuk ka më ç'të bëjë opozita dhe të thërrasë popullin e të përballet me një qeveri që e ka humbur legjitimitetin. Do çojë në situata aspak të këndshme", tha nënkryetari i PD-së, Edi Paloka.

## Akt ligjor për pronat që dalin nga Ministria e Mbrojtjes

Kryetarja e Komisionit të Sigurisë, Ermonela Felaj gjatë një vizite në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për t'u njohur me problematikat e tyre, shprehet se duhet një akt ligjor për pronat që kanë dalë nga administrimi i Ministrisë së Mbrojtjes. Pa dhënë asnjë indicje për kohën, por edhe për emra konkretë, Felaj tha se në disa raste, këto prona janë përdorur nga krimi. "Të ketë një akt ligjor që rregullon të gjitha pronat, të cilat kanë dalë nga përgjegjësitë e Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat shpeshherë në të shkuarën e në të afërmen kanë shërbyer edhe si mundësi që njerëz të përfshirë në krimin e organizuar të përdoren si baza për të fshehur asete të ndryshme kriminale", tha zj.Felaj. Në lidhje me çështjen e radarëve, kryetarja e Komisionit të Sigurisë u shpreh se në 2013-ën, ata u gjetën jashtë funksioni, ndërsa sot sistemi është funksional. "Radarët deri në shtatorin e 2013-ës ishin krejt të fikur, ndërkohë që është bërë maksimumi për t'i riaktivizuar dhe për t'i përdorur në ruajtjen dhe mbrojtjen e integritetit tonë territorial, edhe si pjesë e ndihmës në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikut të narkotikëve", deklaroi deputetja e PS-së. Opozita ka akuzuar Ministrinë e Mbrojtjes se dy vitet e fundit kishte nxjerrë qëllimisht jashtë funksionit qendrën e radarëve për t'u dhënë mundësi grupeve të trafikut të transportonin drogën në rrugë detare.



Zbardhen dokumentet e vendimeve politike të Fatmira Lulit dhe Nurihan Seitit

# PD: Dy anëtarë të KLGJ dhe KLP, gjyqtarë e prokurorë të komunizmit

## "Dënime edhe për rrëzimin e bustit të Enverit"

Valentina Madani

Demokratët publikuan dje prova për anëtaren e KLGJ-së, Fatmira Luli, që sipas tyre si gjyqtare në kohën e diktaturës ka dënuar qytetarë pse morën pjesë në rrëzimin e bustit të Enver Hoxhës më 20 shkurt 1991 apo për hyrjen në ambasada. Partia Demokratike paraqiti fakte dhe prova të reja për kandidatët e përzgjedhur për KLP dhe KLGJ. Më konkretisht, PD-ja paraqiti përmes deputetit Enkelejd Alibeaj dokumente që provojnë se Fatmira Luli dhe Nurihan Seiti kanë dhënë dënime për agjitacion propagandë, kalim të paligjshëm të kufirit, rrëzimin e bustit të Enver Hoxhës apo hyrjen ambasada. Në këto vendime konstatohet se dënimet dhe akuzat ndaj qytetarëve shqiptarë nga anëtarët e sotëm të KLGJ dhe KLP janë dhënë për motive qartazi politike dhe me akuzë për tradhti ndaj vijës së partisë dhe vlerave të partisë. Kryetari i Këshillit të Legjislacionit, Enkeljed Alibeaj, denoncoi dje sesi sistemi i ri i drejtësisë sipas tij po kapet nga qeveria nëpërmjet promovimit në krye të sistemit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të kohës së komunizmit, të përfshirë në gjyqe politike. "Procesi për anëtarët e KLGJ dhe KLP prodhoi një rezultat dramatik, ku sot anëtarë të KLGJ dhe KLP janë jo vetëm kandidatë të përjashtuar nga ONM, jo vetëm kandidatë që nuk plotësojnë kriteret, jo vetëm kandidatë që nuk kanë paguar taksat, të angazhuar në politikë, por edhe individë të kriminalizuar, për shkak se kanë dënuar politikisht qytetarët shqiptarë, thjesht se kanë menduar që liria dhe demokracia janë vlera që duhet të aplikohen edhe në shoqërinë tonë", tha Alibeaj gjatë mbledhjes së Këshillit të Legjislacionit. Sipas PD-së, sistemi i ri i drejtësisë po kapet përmes promovimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të periudhës së komunizmit, që sipas saj janë përfshirë në vendime të drejtpërdrejta politike në atë kohë. "Fatmira Luli (monumenti) është dënim i dhënë prej asaj në 19 prill 1991 për një person që ka marrë pjesë në 20 shkurt në rrëzimin e monumentit të Enver Hoxhës. 'Fatmira Luli (ambasada)' është dënim i dhënë nga Fatmira Luli për një person (minator i Valiasit) që kishte tentuar të futej në ambasadë pas hapjes së ambasadave më 2 korrik 1990. - Fotot Nurihan 1-15 - janë 4 vendime që Nurihan Seiti (KLP) ka dhënë për 4 persona të ndryshëm për akuzat e agjitacion propagandë, kalim i paligjshëm i kufirit", thuhet në dokumentet e publikuara nga Partia Demokratike në Këshillin e Legjislacionit. Në mbledhjen e djeshme të këtij këshilli, kryetari Enkelejd Alibeaj tha se klasa politike duhet të kërkojë ndjesë që nuk arriti të heqë nga drejtësia e re gjyqtarët dhe prokurorët që kanë dhënë vendime në sistemin e kaluar. "U kërkojmë falje të gjitha këtyre viktimave të dënuara thjesht se donin liri, se donin rrëzimin e diktaturës. U kërkojmë falje se për 28 vite gjyqtarët dhe prokurorët e diktaturës u infiltruan dhe na u sollënn këtu, në këtë tryezë", theksoi z.Alibeaj. Por deputeti i PS-së, Alket Hyseni u kundërpërgjigj: "Unë e kuptoj që ju keni kaluar sindromën, se kur gjendeni para mikrofonit të takoni butonin e kasetës që ju kanë detyruar për ta thënë kudo, por mos e ktheni këtë këshill në një miting elektoral të Partisë Demokratike". Këshilli i Legjislacionit ka ngritur grupin e ekspertëve dhe pas një jave do të kenë një dokument me propozimet për përshtatjen e ligjeve të ankimuara të drejtësisë me vendimet që ka dhënë Gjykata Kushtetuese.


Deputeti Enkelejd Alibeaj


Faksimile e një prej vendimeve të Fatmira Lulit

**Grupet**

Këshilli i Legjislacionit ka ngritur grupin e ekspertëve dhe pas një jave do të kenë një dokument me propozimet për përshtatjen e ligjeve të ankimuara të drejtësisë me vendimet që ka dhënë Gjykata Kushtetuese.

## Çuçi: Ekspertë të BE për reformën zgjedhore. Bylykbashi: Jo shitblerje

PD dhe PS kanë gjetur gjuhën e përbashkët sa i përket uljes së shpenzimeve në fushatat zgjedhore, ndërkohë që ekspertë të BE-së do të ndihmojnë për reformën zgjedhore. Edhe pse komisioni i posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore thuajse është bllokuar, në tryezën e organizuar dje prej Këshillit të Evropës partitë shprehën gatishmërinë për përmirësimin ligjor. Ndërsa, kryetari i KQZ-së, Klement Zguri, nënvizon se është e papranueshme që të flitet ende për blerje votash. Për përfaqësuesin e PS-së, Blendi Çuçi po punohet për të arritur në legjislacionin e duhur dhe sipas tij, shpenzimet e tepërta duhen reduktuar. Në të njëjtin mendim me Çuçin ishte dhe Bylykbashi, por në tryezë edhe një herë ai theksoi se nuk duhet lejuar shitblerja e votës. "Paraja e paligjshme që është sot e disponueshme në tregun politik shqiptar është e jashtëzakonshme, me një volum gjigant, që tashmë ka ndikuar thelbësisht jo vetëm procesin e financimit të partive, por edhe rezultatin e zgjedhjeve. Prandaj na duhet të shohim jo vetëm cilat janë nenet specifike të Kodit Zgjedhor", tha z.Bylykbashi.



**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me permbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 16.02.2018 ora $8^{00}$ - $16^{00}$ ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i II per shitjen e pasurise te paluajtshme Truall me Nr. pasurie.6/286 dhe sip.242 $m^2$, Zona Kadastrale Nr.8513, Vol.24, Fq.102 e ndodhur në Rr"V.Kuqi", Lagjia 12, Durrës me vlere fillestare ne ankand 67,200 EURO .
**Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me permbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 16.02.2018 ora $8^{00}$ - $16^{00}$ ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i I per shitjen e pasurise te paluajtshme Ndërtesë me Nr. pasurie.6/56 dhe sip.108.24 $m^2$, Zona Kadastrale Nr.8513,vol.31,fq.121 e ndodhur në Rr"V.Kuqi",Lagjia 12, Durrës me vlere fillestare ne ankand 1,120 EURO .
**Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me permbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 26.02.2017 ora $8^{00}$ - $16^{00}$ ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i III per shitjen e pasurise te paluajtshme Apartament me sipërfaqe totale 65 $m^2$, me Nr pasurie 1/154+1-4, Vol.7, Fq.247 me vlere fillestare ne ankand 24,570 EURO .
**Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

Kryeministri flet për gazetën greke: Shqipëria e madhe? Nuk ekziston si pretendim

# Rama: Jemi pranë një pakti detar me Greqinë, do jetë i drejtë për të dyja palët

## "Çamët? Duam lëvizje të lirë, jo toka"

*Kryeministri Edi Rama ka deklaruar në një intervistë për gazetën greke "Ta Nea" se qeveria shqiptare është shumë pranë marrëveshjes me Greqinë lidhur me kufijtë detare. "Marrëveshja do të jetë e drejtë për të dyja palët" ka thënë kryeministri Rama. Sa i takon çështjes çame, Rama ka deklaruar se është çështje e të drejtave themelore të njeriut. "Kanë të drejtë të udhëtojnë në Greqi si çdo qytetar europian", duke shtuar se "nuk mund të imagjinohet që në shekullin e 21-të disa njerëz nuk mund të hyjnë dot në Greqi".*

### INTERVISTA E PLOTË

**Cili është vlerësimi juaj për marrëdhëniet dypalëshe Greqi-Shqipëri sot?**

Njerëzit e thjeshtë në Shqipëri dhe Greqi, gjithmonë manifestojnë ngrohtësi dhe mikpritje për njëri-tjetrin. Historia na ka bashkuar nga lashtësia dhe përgjatë historisë ekzistojnë shumë shembuj të mëdhenj, të veçantë ku njëra palë të bëjë veprime të mira dhe pozitive ndaj palës tjetër. Shqiptarët strehuan fqinjët e tyre, duke u ofruar ndihmë, duke u ofruar mbështetje robërve fatkeq të luftës greko-italiane dhe grekët bënë të njëjtën gjë me ne, kur ne dolëm nga periudha e turpshme, e fëlliqur e diktaturës komuniste.

Si kryeministër jam angazhuar që nga dita e parë që të ndërtoj një marrëdhënie strategjike midis Greqisë dhe Shqipërisë, të bazuar në respekt të ndërsjellë, në besim dhe dëshirë për të ecur dorë për dore drejt një të ardhmeje të mirë për të dy popujt tanë. Nuk ka qenë e lehtë. Kemi pasur tensionet dhe fërkimet tona, por me gjithë këto, çështjet midis nesh i kemi përballuar me sinqeritet nga të dyja palët.

Përkrah faktit se në këtë periudhë nuk kemi pasur kontakte të nivelit të lartë midis dy qeverive tona, ne kemi mundur të zhvillojmë dhe t'i japim frymë një mirëkuptimi të thellë të shqetësimeve tona nga të dyja palët. Besoj se tani gjendemi në një pozicion për t'i përmirësuar në mënyrë të rëndësishme marrëdhëniet tona, duke i ndërtuar ato mbi një punë, e cila është bërë nga të dyja palët për të përballuar çështjet e së shkuarës, duke na lejuar ne të ecim/udhëtojmë së bashku drejt një të ardhmeje më të mirë për popujt tanë, kombet tona dhe për rajonin tonë. Jam i bindur se e gjithë puna e vështirë, të cilën kemi marrë përsipër së shpejti në vazhdim do të japë frytet e veta dhe do të na bëjë të gjithëve krenarë.

**Dy vendet janë në negociata për të zgjidhur çështje të ndryshme. Si kryeministër e keni shtruar çështjen e çamëve. Çfarë kërkohet saktësisht nga Tirana?**

Nga pala greke, kjo çështje është trajtuar si shfaqje e një agjendë të fshehtë nga ana jonë për krijimin e Shqipërisë së madhe. Dua të jem tepër i qartë, ashtu sikurse jemi edhe me miqtë tanë në Athinë, që një pretendim i tillë territorial thjesht nuk ekziston. Nuk mund të jem dakord më shumë se kaq me ju, përveç se çështje territoriale midis Greqisë dhe Shqipërisë nuk mund të ekzistojë.

**MARREDHENIET**

Gjendemi në një pozicion për t'i përmirësuar në mënyrë të rëndësishme marrëdhëniet tona, duke i ndërtuar ato mbi një punë, e cila është bërë nga të dyja palët për të përballuar çështjet e së shkuarës, duke na lejuar ne të ecim/udhëtojmë së bashku drejt një të ardhmeje më të mirë.



Faksimile e gazetës greke "Ta Nea"

**PRETENDIMET**

"Nga pala greke, kjo çështje është trajtuar si shfaqje e një agjendë të fshehtë nga ana jonë për krijimin e Shqipërisë së madhe. Dua të jem tepër i qartë, ashtu sikurse jemi edhe me miqtë tanë në Athinë, që një pretendim i tillë territorial thjesht nuk ekziston. Nuk mund të jem dakord më shumë se kaq me ju, përveçse çështje territoriale midis Greqisë dhe Shqipërisë nuk mund të ekzistojë", tha Rama.

Burimet që e nxisin një fantazi të tillë, që nganjëherë gjejnë vend në cepat e skajshëm ekstremë të skenës politike, kërcënojnë për të shtrembëruar të vërtetën dhe për të minuar të ardhmen. Pra, duhet që të gjithë të kuptojnë qartë se për aq sa na takon ne këtu në Shqipëri, çështja e çamëve ekziston vetëm si çështje themelore e të drejtave të bashkëpatriotëve tanë shqiptarë, të cilët dikur jetonin në vendin tuaj dhe asgjë më tepër më tej. Sinqerisht, nuk besoj se çdo njeri i mençur do të ishte në kundërshtim me qëndrimin që ata njerëz gëzojnë të drejtën të udhëtojnë dhe të vizitojnë Greqinë, ose që ata apo fëmijët e tyre duhet të kenë mundësinë për të fituar të drejtat mbi pasurinë në rrugë ligjore, ashtu sikurse natyrisht çdo qytetar evropian vepron. A mund ta imagjinoni sot në Evropën e shekullit të 21 që njerëz të plakur, burra dhe gra në Shqipëri e kanë të ndaluar të kalojnë kufirin e Greqisë fqinje, sepse rrënjët e tyre janë nga një rajon i vendit tuaj? E njëjta gjë ekziston dhe për absurditetin e ruajtjes së Ligjit të Luftës midis Greqisë dhe Shqipërisë, një fantazmë e gjallë e së shkuarës që qëndron pezull midis nesh, pasojat ligjore të të cilit krijojnë pengesa të padurueshme për qytetarët që përmenda më lart, por edhe për shumë të tjerë.

**Sa afër jemi me përcaktimin e AOZ-ve midis Greqisë dhe Shqipërisë?**

Jam shumë i kënaqur që ndërsa kemi rënë dakord të ulemi në tryezë së bashku dhe të bisedojmë me zemra dhe mendje të hapura, ashtu sikurse bëjnë popujt tanë të cilët jetojnë si fqinjë, si në Shqipëri dhe në Greqi, jo vetëm që mund të zgjidhim çdo mosmarrëveshje dhe keqkuptim të së shkuarës, por mund gjithashtu të gjejmë zgjidhjet më të mira për të ardhmen tonë të përbashkët. Jemi pranë një marrëveshjeje për kufirin detar, e cila do të jetë e drejtë edhe për Shqipërinë, edhe për Greqinë.

**Të martën, BE-ja do të çelë diskutimet për zgjerimin e saj drejt vendeve të Ballkanit. Çfarë dëshironi të dëgjoni nga BE?**

Sot BE-ja ka nevojë për Ballkanin po aq sa Ballkani ka nevojë për BE-në. Kushdo që nuk e beson, nuk e kupton në realitet rëndësinë e Ballkanit për paqe dhe stabilitet në Evropë. Unë dëshiroj të dëgjoj nga Këshilli Evropian një strategji të qartë për bashkimin/trupëzimin e Ballkanit me Bashkimin Evropian si pjesë e një strategjie më të gjerë për Bashkimin Evropian. Në një periudhë të ndryshimeve të rëndësishme në botë, kemi nevojë për një BE me strategji, me rol udhëheqës botëror/global, e dedikuar ndaj vizionit dhe vlerave të saj, në vend që të drejtohet ndaj taktikave dritëshkurtër të paqarta dhe pa marrë vendime mbi bazë të kritereve afatshkurtra politike. Shqipëria ka të drejtën e një rekomandimi të drejtpërdrejtë që të hapen negociatat dhe nuk pres asgjë më pak nga Komisioni i Evropës si fillim dhe nga Këshilli pak më vonë.

**DISKUTIMET**

Sot BE-ja ka nevojë për Ballkanin po aq sa Ballkani ka nevojë për BE-në. Kushdo që nuk e beson, nuk e kupton në realitet rëndësinë e Ballkanit për paqe dhe stabilitet në Evropë. Unë dëshiroj të dëgjoj nga KE një strategji të qartë për bashkimin/trupëzimin e Ballkanit me BE si pjesë e një strategjie më të gjerë për Bashkimin Evropian.

**Qeveria greke është duke u përballur edhe me zgjidhjen e çështjes së emrit të FYROM. Cili është mendimi juaj për këtë temë?**

Ka ardhur koha të zgjidhet kjo çështje dhe ku ka dëshirë, gjithmonë ka edhe mënyra. Greqia ka kaluar kohë të vështira për shkak të një krize të dhimbshme, e cila pati si efekt anësor që të mbajë të vetmin vend - anëtar të BE-së në rajonin tonë larg nga zhvillimet periferike dhe betejat e viteve të fundit. Përpos këtyre, për arsye të dëshirës së fortë politike për të luftuar me reforma të dhimbshme dhe masa të vështira, duket se vendi juaj e ka gjetur rrugën e tij dhe rikthehet në politikën periferike. Ky është një lajm i shkëlqyer për të gjithë ne në rajon. Zgjidhja e çështjes së emrit është në interes të të gjithëve dhe shpreh interesat e vendit tuaj gjithashtu. Një Maqedoni (sido që të quhet në bazë të marrëveshjes) stabël, demokratike dhe e begatë, është e rëndësishme për të ardhmen e popullit të saj, të rajonit dhe të Greqisë gjithashtu. Shpresoj të mbizotërojë vizioni strategjik dhe vendosmëria për zgjidhjen e kësaj çështjeje, pasi taktika të politikave dritëshkurtër nuk do të na drejtojnë drejt së ardhmes, ku të gjithë palët gëzojnë të drejtën.

***Botuar në faqen e parë të gazetës "Ta Nea"**
**Intervistoi Aleksia Kefala**

**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me permbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyra 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 02.03.2018 ora 8ºº - 16ºº ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i III per shitjen e pasurise te paluajtshme Arë me sipërfaqe totale 1000 m², numër pasurie 294/33, Zona Kadastrale 3339, Volumi 11, Faqe 208 e ndodhur në Vrrinë, Durrës në pronësi të Z.Ardian Rexhep Kola me vlere fillestare ne ankand 1,764,000 LEKE .
**Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "EXECUTORES LITIUM" (EXC LIT) sh.p.k

**Shoqëria Përmbarimore "Executores Litium " sh.p.k**
**do të zhvillojë ankandin e pare për pasurinë e paluajtshme :**

**Njësi me nr. Pasurie 6/121-N12, vol 22, fq.28, e regjistruar në ZVRPP Tiranë ZK 8160, me sipërfaqe 37 m2, në pronësi të Albert Sokol Elezi**
***Cmimi me të cilin do të filloje ankandi është në vlerën 20,720 Euro***
**Ankandi do të zhvillohet në datë 05.03.2018 ora 16:00, në zyrën përmbarimore "Executores Litium" sh.p.k, me adresë *Blv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknoprojekt, shk 1, kati 4, ap 10, Tirane*.**

**Njoftim për shitje me ankand**

**Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e debitorit** Shoqeria "Extra Cleaner" sh.p.k dhe Hipotekuese A Milla**. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga :**
·" Apartament" me numur pasurie 1/126+1 - 4 Zone Kadastrale 8170 Volumi 1, Faqe 154. me siperfaqe 75.1 m2. në adresën Rr" Q Stafa" pall 8, shk 1, kati dyte , Ap 4 Tiranë
Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 42.056 Euro
Ankandi do të zhvillohet në datë 21.02.2018 në orën 15:00 në selin e shoqerise Bulv "Gjergj Fishta" Pall. i shoqërisë "Gora" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Ofertuesit duhet te paraqiten ose të kontaktojnë **tel. 00355 67 20 82 543** ose e-mailit **ilir_dervishaj@yahoo.com** si dhe WEB **www.powerjustice-al.com**.

### Kreu ALUIZNI-t, thirrje banorëve: Bashkëpunoni për të përfunduar procesin

# 1230 pallate, Lame: Ja si do pajisen banorët me tapi

## *Marrin certifikatë pronësie 4 kulla nga 11-katëshe*

Ornela Manjani

Drejtori i ALUIZNI-t, Artan Lame, ka shpërndare dje lejet e para të legalizimeve për pallatet që janë ndërtuar në shkelje të lejes së ndërtimit. Lame ka bërë të ditur procedurat që do të ndiqen për pajisjen me leje legalizimi dhe më pas me certifikatë pronësie për banorët e pallateve kur ndërtuesi ka lënë pa kryer procesin e regjistrimit në hipotekë. Kreu i ALUIZNI-t pasi ka shpjeguar tri raste për tre ndërtues, që kanë njohur rrugën e zgjidhjes, u ka bërë thirrje banorëve të pallateve pa leje që të bashkëpunojnë për pajisjen me tapi të pronave të tyre. Nga vendimi i qeverisë që parashikon legalizimin e 1230 pallateve përfitojnë 30 mijë familje.

**TAKIMI**

Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, Artan Lame së bashku me drejtoreshën e 'Tirana 2', Orjeta Myzeqari u dorëzuan lejet e legalizimeve banorëve të pallatit që përfituan nga VKM nr. 19, e cila ka si qëllim hipotekimin e pallateve, që janë të braktisur nga pronarët apo kanë shkelur lejen e ndërtimit. Drejtoria 'Tirana 2' ka emetuar rreth 40 leje për këto ndërtime, nga ku në emër të banorëve janë 16 pallate dhe në emër të subjekteve janë 24 pallate. Në proces janë edhe 20 pallate. Ndërsa, në total janë 210 kërkesa për përfshirje në procesin e legalizimit. "Problematika e pallateve ka qenë përherë në vëmendjen tonë. Në Bashkinë Tiranë (këtu flas vetëm për drejtorinë 'Tirana-2'), administrohen sot rreth 210 kërkesa për legalizim ndërtimesh mbi 5 kate, me leje ndërtimi të shkelura. Përfshijmë këtu deklarime të bëra nga vetë subjektet, si dhe nga banorët e këtyre pallateve. Drejtoria 'Tirana-2' ka emetuar rreth 40 leje për këto ndërtime, mes të cilave ndajmë si kategori: 1. Leje të emetuara në emër të banorëve janë 16 pallate. 2. Leje të emetuara në emër të subjekteve ndërtues, 24 pallate. Gjithashtu, në proces pranë drejtorisë janë edhe rreth 20 pallate të tjera, që do të thotë se janë njoftuar subjektet ndërtues dhe jemi në pritje të reagimit të tyre, ose procedura për ta ka kaluar afatet e njoftimit dhe tanimë u takon banorëve për të vijuar", deklaroi Lame.

**KREU I ALUIZNI-T, ARTAN LAME TREGON TRI RASTE QË JANË ZGJIDHUR**

**RASTI 1.**

"Pallati poshtë të cilit jemi mbledhur i takon rastit të emetimit të lejes për banorët. Ndërtimi i deklaruar për legalizim si fillim është pajisur me leje ndërtimi sipas Vendimit nr. 10, datë 15.12.2001, të KRRT Bashkia Tiranë, në favor të firmës, për 'Objekt 7 kate me 1 kat parkim nëntokë'. Duke qenë se kontrata e sipërmarrjes ndërmjet firmës nuk është realizuar për mungesë fondesh, ndërtimi është kryer nga investimi i përbashkët dhe periodik i gjithë banorëve posedues të njësive përkatëse, bashkë me përfaqësuesin e tyre, Aleksandër Culli, të cilët nuk e kanë respektuar projektin fillestar të miratuar dhe ndër vite kanë kryer shkelje. Me përcaktimin e një përfaqësuesi nga banorët, u realizua prej tij mbledhja dhe administrimi i dokumentacionit të kërkuar nga ligji. Gjithashtu, u përpilua dhe aktekspertiza e qëndrueshmërisë së objektit, përcaktuar në VKM 19, si dokument i detyruar për dorëzim prej banorëve. Vlen të theksoj se ky është një prej pak dokumenteve, i cili është detyrim ligjor të realizohet prej banorëve, por të cilin shumë pallate të tjera nuk kanë arritur ta prodhojnë, duke dështuar në bashkëpunimin mes vetë banorëve. Pas një pune dhe bashkëpunimi disamujor, u arrit të mbyllej procedura dhe të emetohej leja e legalizimit për këtë ndërtim dhe banorët që e posedojnë atë. Rasti është dërguar për regjistrim në ZVRPP, e cila po procedon për regjistrim. Së shpejti, banorët do të kenë në duar certifikatat e pronës për banesat apo njësitë që posedojnë. Me këtë proces, këtij subjekti iu legalizuan dhe i bëhen të regjistrueshme për hipotekë rreth 2600 m2 ndërtim".



Drejtori i ALUZNI-t Artan Lame, gjatë takimit të djeshëm me banorët

**RASTI 2.**

"Rasti i dytë është rasti kur vetë subjekti ndërtues ka shprehur interes si dhe ka ndjekur procedurën për legalizim të godinës, subjekti 'TIRHINO'. Subjekti ndërtues është pajisur nga Bashkia Tiranë me leje ndërtimi nr. 867, datë 25.12.1998, për ndërtimin e 'Kompleks banimi me 4 kulla, 11 kate' në Selitën e Vogël, në pronë të familjes Kika. Në vijim, duke qenë se ky subjekt ka kryer shkelje të projektit të miratuar, ka aplikuar pranë Bashkisë Tiranë për legalizim. Në bashkëpunim me ZVRPP, për sqarimin e rastit lidhur me marrëdhëniet mes pronarëve të truallit dhe subjektit ndërtues, u arrit më në fund zgjidhja. Pas evidentimit në terren nga specialistët e caktuar, u gjenerua materiali tekniko-ligjor dhe u emetua leja e legalizimit në favor të subjektit për kullat 'A&C', 12 kate + 2 kate parkim. Dokumentacioni përkatës është dërguar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrimin e pasurisë së legalizuar. Këtij subjekti iu legalizuan dhe iu bëhen të regjistrueshme në hipotekë rreth 17.200 m2 ndërtim, ose 90 apartamente banimi, 30 njësi tregtare, 2 kate parkim me 30 poste parkimi".

**RASTI 3**

"Ngjitur me pallatin tuaj është ndërtimi i një subjekti ndërtues 'EDAL', i cili rezulton të jetë tepër problematik. Në këtë rast, janë pronaret e truallit që kanë bllokuar me proces gjyqësor firmën ndërtuese për procedimin me legalizim, pasi firma i ka shitur apartamentet më shumë se një herë. Edhe një tjetër firmë, me të cilën jemi gjithashtu në proces gjyqësor, për të njëjtën arsye si më lart, punuam me drejtim legalizimin e pallateve në emër të firmës që ka marrë lejen dhe në fund pasi ata nuk arritën të paguajnë faturat, na bllokuan me gjyq. Në këtë rast, sepse kjo firmë ka disa raste të tjera për të cilat do të punohet në vazhdim, mbahen peng rreth 50.000 m2 ndërtim, që mund të kishin filluar të regjistroheshin në ZVRPP, nëse do kish pasur bashkëpunim të mirë. Ne kemi filluar procedurën me njoftim edhe për rreth 20 objekte të tjera, për të cilat ende nuk kemi reagim nga firmat, një pjesë e të cilave sot ende bashkia i pajis me leje ndërtimi. Jemi duke bashkëpunuar ndërkohe me bashkinë, për saktësimin e këtyre subjekteve, të cilat rrezikojnë të mos marrin më leje ndërtimi deri në përfundim të procedurave të legalizimeve të objekteve të ndërtuara më herët".

**PROBLEMATIKA**

"Ajo që vëmë re në procesin tonë, në shumë raste është mungesa e bashkëpunimit me banorët. Dëshira për t'u pajisur me certifikatë pronësie, ky është i vetmi qëllim, nuk krahasohet me nivelin e bashkëpunimit që duhet të kishin mes tyre, detyrim i përcaktuar nga jeta komunitare dhe qëllimi i përbashkët. Vërtet kanë blerë prona, por gabimi i tyre bashkohet me gabimin e ndërtuesve deri në mospërmbyllje me certifikata pasurie. Mbase ky përfundim nuk është niveli i përgjithshëm i rasteve, por nga këto raste që kemi punuar, kjo gjendje ekziston. Rastet kur ndërtuesit spekulojnë dhe u kërkojnë lekë banorëve për t'u vazhduar procesin e legalizimit. Rastet kur banorët nuk merren vesh me njëri-tjetrin, apo me ndërtuesin, apo me pronarët e tokës", - thotë Lame.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë 1 vjeçare"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6,384,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë 1 vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 01 Mars 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

*United Nations Development Programme*

**VACANCY ANNOUNCEMENT**

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.

***Post Title:*** *Regional Coordinator, Tirana Region*
***Duty station:*** *Tirana*
**Duration of Assignment:** 15 wds/month for the time period of 1 year
**Type of Contract:** Individual Contract
**Educational Background:** Graduate studies preferable in public policy, public administration, law, development, human rights or other relevant discipline, or relevant work experience.
**Work Experience:** At least 3 years of experience in dealing with local authorities, local governance, capacity building of local stakeholders, local development or similar.
Proven familiarity with the specific region for which the application is made, in terms of local administration, local counselors, traditional cooperation, social and interest groups etc; Good knowledge of key government/nongovernment institutions as well as international ones active in the specific region.
In-depth understanding of country economic, political social, institutional and technical issues as they relate to decentralization and local administration
**Demonstrated understanding of Albania's local governance system.**
**Experience in integrated governance programming / institutional devleopment.**

**Tentative Starting Date:** 03 March 2018
**Deadline for Application:** 18 February 2018

Job Description: **Available at UNDP site:**
http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/
Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

### Sinan Topi: Beqja më mori 180 mijë euro dhe nuk m'i ktheu më

## Gjyqi i Shullazit, avokati: Besim Hajdarmataj kërcënoi Beqjan që të dëshmojë kundër të akuzuarit

Në seancën gjyqësore të zhvilluar ditën e djeshme të Krimet e Rënda ndaj Emiljano Shullazit dhe grupit të tij, kanë dalë përpara trupit gjykues për të dëshmuar dy ish-avokatët e të arrestuarve, Nexhdet Kambo dhe Alban Qafo. Gjatë seancës avokati Kambo ka treguar për takimin e kryer me Ylvi Beqajn, duke lëshuar akuza të forta për prokurorin Besim Hajdarmataj, i cili sipas tij i ka bërë presion dëshmitarit të mbrojtur Ylvi Beqja që të dëshmojë kundër të akuzuarit. Ai u shpreh se teksa takonte biznesmenin si mik të Shullazit, Beqja ka deklaruar se është kërcënuar nga Hajdarmataj se nëse nuk dëshmon kundër Shullazit, do arrestohej edhe ai. "Ylvi Beqajn e kam njohur pasi u arrestua Shullazi dhe Dani, pasi isha avokat i tyre gjatë seancës së masave. Beqaj me deklaroi se Shullazin e kishte mik se e kishte ndihmuar për regjistrimin e hotel Vollgës si pronë. E kam takuar disa herë pasi më vinte në zyrë. Në një nga takimet më deklaroi se ishte kërcënuar nga disa persona, mes tyre dhe kreu i Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Besim Hajdarmataj, se nëse nuk dëshmonte në favor të shtetit kundër Emiliano Shullazit atëherë prokuroria do e arrestonte dhe atë për financim të grupit kriminal", tha Kambo. Kjo dëshmi është konfirmuar edhe nga avokati tjetër, Alban Qafo. Më tej Kambo shtoi së Ylvi i kishte kërkuar lekë, pasi donte të largohet jashtë vendit, me arsyes se kishte frikë për jetën. "Ylviu më kërkoi që t'i them çunave se do lekë pasi do ikte jashtë vendit se ka frikë për jetën. Më kërkoi borxh dhe mua, por e përzura dhe nga ai moment s'kam më kontakt", u shpreh Kambo gjatë dëshmisë. Ndërkohë një tjetër dëshmi e dhënë dje, është ajo e biznesmenit Sinan Topi. Ai ka deklaruar se ka njohje me Beqajn, i cili sipas tij i ka marrë 180 mijë euro dhe nuk ia ka kthyer më. "Beqja më ka mashtruar, prej dy vitesh s'më ka kthyer asnjë lek", dëshmoi Sinan Topi. Në seancën e së martës ka munguar dëshmitari tjetër i kërkuar nga prokuroria, Jani Zaka i cili ndodhet prej dy vitesh në arrati.

**AVOKATI**
Në një nga takimet më deklaroi se ishte kërcënuar nga disa persona, mes tyre dhe kreu i Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Besim Hajdarmataj, se nëse nuk dëshmonte në favor të shtetit kundër Emiliano Shullazit atëherë prokuroria do e arrestonte dhe atë për financim të grupit kriminal",- dëshmoi avokati Nexhdet Kambo.


Emiljano Shullazi

### Gjykata: Ish-speciali e Meshini do të qëndrojnë në paraburgime të ndryshme

# Vrasja e Kasmit, 'Kathimerini': U urdhërua nga shqiptar në burgjet greke

## *"Ja dosja penale e ekzekutorit të 41-vjeçarit"*

Ina Allkanjari

Mediat greke nxjerrin detaje të reja në lidhje me ekzekutimin e Devi Kasmit pasditen e 29 janarit në kryeqytet. 'Kathimerini' shkruan se vrasja e 41-vjeçarit dyshohet se është urdhëruar nga shqiptarë të dënuar për trafik droge në burgjet greke. Media greke në lidhje me këtë informacion iu referohet zyrtarëve të lartë të policisë që po ndjekin çështjen. Ndërkohë sipas hetimeve, ka qenë pikërisht greku Efthymoius, i cili cilësohet si vrasës me pagesë, ai që kreu ekzekutimin. Sakaq ditën e djeshme gjykata e Tiranës vendosi që shtetasi grek Efthymio Efthymious, të mos qëndrojë në të njëjtin paraburgim me 23-vjeçarin Mario Meshini, i cili u arrestua si bashkëpunëtor. Ky vendim do të jetë në fuqi të paktën deri në përfundim të hetimeve. Me vendim të gjykatës, Mario Meshini do të qëndrojë në paraburgimin 302 në Tiranë, ndërsa ish-speciali grek në paraburgimin e Bradasheshit në Elbasan, bashke me 3 personat e tjerë që akuzohen si bashkëpunëtorë. Gjykata e Krimeve të Rënda ka vendosur masën e sigurisë "arrest me burg" për Efthymio Efthymious, Elton Halipaj, Malvin Dinellari dhe Elton Hoxhallarin si të dyshuar për vrasjen e Devi Kasmit. Gjithashtu, do të qëndrojë në burg edhe 25-vjeçari Mario Meshini për të cilin ekzistojnë dyshime se ka nxjerrë në prite Kasmin, pranë shtëpisë që ky i fundit e përdorte si bazë për trafikun e drogës.

**GREKU EFTHYMIO EFTHYMIOUS**

Ish-agjenti special grek, Efthymious ka shërbyer si roje në ambasadën shqiptare në Athinë, si edhe për mbrojtjen e objekteve publike në sheshin "Sintagma". Mësohet se greku në vitin 2008 është arrestuar për trafik klandestinësh drejt Greqisë. Ndërkohë në vitin 2009 në Frankfurt u kap me 5.5 kg kokainë që vinte nga Venezuela. Media greke raporton se Efthymiou u lirua nga policia në vitin 2012. Por duket se aktivitetet kriminale të grekut vijojnë, pasi ish-speciali u arrestua në 2016 në Artë për trafik droge dhe qëndroi në burg 10 muaj. Në gjyqin që u bë në 2017 në Janinë, ranë akuzat se bëhej fjalë për një grup kriminal, dhe të pandehurit e tjerë u shpallën të pafajshëm përveç Efthymiou, i cili u dënua si përdorues droge, kokainë. Ai mori një dënim prej 4 vitesh me kusht, ndaj dhe u lirua.


Shtetasi grek Efthymio Efthymious

**VENDIMI**
Gjykata e Tiranës vendosi që shtetasi grek Efthymio Efthymious, të mos qëndrojë në të njëjtin paraburgim me 25-vjeçarin Mario Meshini, i cili u arrestua si bashkëpunëtor. Ky vendim do të jetë në fuqi të paktën deri në përfundim të hetimeve.

**SHKURT**

### Shoqata e Policëve në Lirim: Në emërimin e Ardi Veliu, u shkel ligji

Shoqata e Policëve në Lirim ka reaguar pas emërimit të Ardi Veliut në krye të Policisë së Shtetit. Sipas tyre, në këtë emërim ka shkelje ligjit, pasi Veliu nuk i ka marrë gradat në zbatim të ligjit. Në një reagim në faqen zyrtare në "Facebook", Shoqata thekson se për Ardi Veliun nuk janë respektuar vitet e qëndrimit në detyrë. Sipas tyre, Ardi Veliu i mori gradat për 4 vite, jo 11 vite sipas ligjit. Ndërkohë pas emërimit të Ardi Veliut në krye të Policisë së Shtetit, posti i Drejtorit të Policisë Tiranë mbetet vakant. Bëhet me dije se kandidatët më të përfolur për të drejtuar uniformat blu në kryeqytet janë Gentjan Shehaj, Drejtor i Policisë Vlorë dhe Alfred Çepe, Drejtor i Policisë së Durrësit.

### 9 mln USD dëm të shtetit, dorëzohet në polici Sokol Lami

Biznesmeni Sokol Lami është vënë në pranga dy javë pasi u shpall në kërkim nga policia e Tiranës. Bëhet me dije se Lami është vetëdorëzuar nën shoqërinë e avokatit të tij në polici. Ai ishte shpallur në kërkim për mashtrim me TVSH nga Krimi Ekonomik. Skema mashtruese në lidhje me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, i ka shkaktuar shtetit një dëm prej 9 milionë dollarësh. Për këtë skemë mashtruese policia ka arrestuar 6 persona dhe ka shpallur në kërkim 5 të tjerë. Nga hetimi disa mujor rezultoi se këta persona kanë regjistruar subjekte tregtare në mënyrë fiktive, pa asnjë lloj aktiviteti, me qëllim tërheqjes e bllokeve Tatimore, duke lëshuar fatura TVSH-je shitje (fiktive) për subjekte të treta.

### "Çdo gjë është me dokumente, sulmet ndaj meje janë politike"

## Abuzimet me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan, reagon Haxhinasto: Jam i hapur për verifikime

**TIRANE** - Pas verifikimeve të nisura nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për dosjen e rrugës Tiranë -Elbasan, ndaj ishministrit të transporteve Edmond Haxhinasto, ky i fundit ka reaguar duke dhënë një prononcim për mediat. Ish-ministri deklaroi se nuk ka frikë nga verifikimet dhe hetimet e prokurorisë ndaj tij, lidhur me abuzimet me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan, dhe aludoi se bëhet fjalë për sulme politike. "Nuk më shqetësojnë as verifikimet dhe as hetimet. Unë kam bërë një drejtim politik dhe veprimtaria është e bazuar në dokumente. Koha e gjyqeve ka mbaruar dhe, nëse më godasin politikisht, unë do i përgjigjem politikisht shumë rreptë"- tha Haxhinasto. Ish-ministri Edmond Haxhinasto po hetohet për abuzime me rrugën Tiranë- Elbasan e cila edhe pse ka nisur të ndërtohet që në vitin 2011, ende nuk ka përfunduar. Mësohet se verifikimet për Haxhinaston kanë nisur për shkak se nuk ka marrë masa pas disa auditeve që janë bërë për këtë rrugë. Për dosjen e abuzimeve me rrugët Krimet e Rënda kanë nxjerrë 3 masa arresti për ish-drejtorin e rrugëve Dashamir Xhika dhe Albens Alite e Aksel Qurduka. Për Dashamir Xhikën të njëjtën ditë gjykata e Elbasanit konfirmoi një tjetër masë sigurie me burg, për dosjen e rrugës Elbasan-Gjinar. Në këtë dosje Dashamir Xhika dhe Andi Toma akuzohen për shpërdorim fondesh për rrugën e Gjinarit. Avokati i Andi Tomës i ftuar në emisionin "Debati në Channel One", deklaroi ditën e djeshme se, nëse nuk e nxjerr të pafajshëm ish-drejtorin e Përgjithshëm të ARRSH do grisë licencën e avokatit. Fana akuzoi edhe gjykatësen dhe prokuroren e çështjes, që sipas tij kanë manipuluar procedurat e kësaj dosjeje. "Gjykatësja Idush Maliqi ka bërë shkelje në mënyrë flagrante të hapura të procedurave duke marrë copy-paste kërkesën e prokurorisë, dhe duke e vendosur si vendim",-tha ai.


Ish-ministri i Transporteve Edmond Haxhinasto

# MATURA SHTETËRORE 2018
## PROVIMET E DETYRUESHME

MASR shpall programet orientuese për lëndët Gjuhë Shqipe e Letërsi, Matematikë e Anglisht

# Provimet e detyruara të maturës 2018, ja ku duhet të bazoheni

## Lista e veprave për testin kombëtar të letërsisë





Voltiza Duro

Të gjithë maturantët e vitit mësimor 2017-2018 do të mund të njihen tashmë me programet orientuese mbi provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2018. Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë ka hartuar programet për secilën lëndë që kanë marrë miratimin e janë firmosur nga ministrja Lindita Nikolla. "Gazeta Shqiptare" publikon sot udhëzimet ku do të bazohet provimi kombëtar i Maturës Shtetërore për lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Matematikë Bërthamë si dhe Anglisht; të tria këto testime të detyrueshme. "Lënda e gjuhës shqipe dhe e letërsisë është provim i detyruar i Maturës Shtetërore për të gjithë nxënësit që mbarojnë shkollën e mesme. Për këtë, ata i nënshtrohen një testi, në përbërje të të cilit janë njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë lëndë, gjatë viteve të shkollës së mesme. Ky test zhvillohet mbi bazën e programit orientues",-citohet në program. Ky i fundit mbështetet në programet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në kurrikulën bërthamë; udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës së re të gjimnazit; standardet e të nxënit dhe të arritjeve për fushën e këtyre 2 lëndëve si dhe në udhëzimin e MASR-së "Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore".

### PROVIMI I GJUHË-LETËRSISË

Testi i Maturës Shtetërore 2018-të do të ketë në përbërje fragmente nga tekste të ndryshme (tekst tregimtar, tekst poetik, tekst dramatik, tekst bindës/argumentues, tekst përshkrues, tekst shpjegues, tekst informativ, tekst eseistik, tekst kulturologjik), jo patjetër të punuara në klasë. Pra, maturanti do të testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Në program bëhet me dije se përqindja e pikëve në test për secilin nivel do të jetë 40% për nivelin bazë, po 40% për nivelin mesatar si dhe 20% për nivelin e lartë. Në pjesën e parë të testit do të ketë 45% tekst letrar ndërsa në pjesën e dytë 55% tekst jo letrar. "Në përgatitjen e maturantëve për provimin e Maturës Shtetërore do të punohet për përvetësimin e aftësive dhe teknikave zbuluese, shpjeguese, zbatuese, analizuese, sintetizuese dhe vlerësuese. Këto aftësi dhe teknika, nxënësit do t'i demonstrojnë dhe do t'i zbatojnë në tekste tregimtare, poetike, dramatike, bindëse/argumentuese, përshkruese, shpjeguese, informative, eseistike, kulturologjike, të punuara ose jo më parë në klasë.",-theksohet në programin orientues të miratuar nga Nikolla. Maturantëve iu del si detyrë që të aftësohen për objektivat e programit orientues si dhe të jenë të aftë të demonstrojnë arritjet e tyre në të gjitha llojet e teksteve. Në programin orientues për provimin kombëtar të Maturës Shtetërore 2018-të për lëndën letërsi dhe gjuhë shqipe janë përcaktuar të gjitha objektivat sipas linjave që duhet të arrihen nga nxënësi.



Faksimile e programeve orientuese të firmosura nga Nikolla

### PROVIMI I MATEMATIKËS BËRTHAMË

Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë ka publikuar edhe programin orientues për Maturën Shtetërore 2018-të mbi provimin e detyrueshëm për gjimnazet në lëndën e Matematikës Bërthamë. Nëpërmjet këtij programi synohet përgatitja e nxënësve të vitit të tretë gjimnaz për testimin final në këtë lëndë. "Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndës. Njëherazi, programi orientues ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve, sepse mundëson zhvillimin e testimeve përmbledhëse",-theksohet në programin orientues për lëndën e matematikës bërthamë. Ky i fundit bazohet në programet e matematikës bërthamë të gjimnazit sipas klasave të ndryshme dhe përfshin njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve. Në fokus të përgatitjes së nxënësve duhet të vendoset modelimi matematik, aftësia për të zgjidhur problema, aftësia për të përdorur njohuritë matematike në situata nga jeta reale dhe në problema me përmbajtje nga shkencat e tjera, si dhe aftësia e të menduarit kritik. Gjithashtu, edhe aftësia për të argumentuar, për të gjykuar, për të vërtetuar, si dhe aftësitë ndërkurrikulare të kurrikulës së gjimnazit duhet të jenë në vëmendje përgjatë përgatitjes për provimin e matematikës. "Programi orientues është hartuar sipas linjave e nënlinjave të njëjta me ato të programeve të matematikës bërthamë për gjimnazin",-citohet në programin e miratuar nga MASR.

Kështu programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndës së matematikës bërthamë është mbështetur në programet e lëndës së matematikës bërthamë për klasat 10-12; udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës së gjimnazit si dhe standardet e të nxënit dhe arritjeve të fushës së matematikës. Kështu testimi do të hartohet bazuar në 7 linja kryesore si numri dhe veprimet me numra që ka 7% të peshës në provim; matja me 10%; algjebra po me 10%; funksioni që zë 15% të peshës së testimit e gjeometria me 25% të saj. Ndërkohë edhe njehsimi diferencial e integral ka një peshë në testim prej 20%, ndërsa statistika, probabiliteti dhe kombinatorika zënë 13% të peshës në provimin final. Në linjën "Numri dhe veprimet me numrin" nxënësit duhet të fokusohen në bashkësitë numerike, veprime me numra si dhe matematika dhe financa e jetës së përditshme. Ndërsa në linjën e dytë "Algjebër" duhet të kenë parasysh shprehjet shkronjore dhe zgjidhjen e ekuacioneve, inekuacioneve, sistemeve; në një kohë që te "Matja" duhet të kenë parasysh matjet jo të drejtpërdrejta si dhe matjet me formula. Ndërkohë gjeometria në plan dhe ajo në hapësirë si dhe vijat e gradës së dytë duhet të jenë në fokusin e linjës së katër "Gjeometria"; ndërsa në linjën "Funksioni" nxënësit duhet të tregojnë kujdes me kuptimin dhe paraqitjen e funksionit dhe limitit ndërsa në linjën "Njehsimi diferencial e integral" duhet të përqëndrohen më së tepërmi tek derivati e njehsimi integral. Ndërsa në linjën e shtatë "Statistikë, probabilitet dhe kombinatorikë" maturantët duhet të kenë parasysh statistikën, probabilitetin dhe elementët e njehsimit kombinator.

### PROVIMI I ANGLISHTES

Sot në "Gazeta Shqiptare" publikohen udhëzimet edhe mbi testimin e tretë të detyrueshëm për Maturën Shtetërore 2018, ai i gjuhës angleze në nivelin B1.Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës angleze, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale. "Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën angleze si provim i detyruar, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional. Programi Orientues është hartuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve, zhvillimet e tyre individuale duke u dhënë mundësi për sukses në atë çka i pret",-theksohet në programin orientues të firmosur nga ministrja e arsimit. Ky program synon të ndihmojë maturantin në përgatitjen e tij për provimin e gjuhës angleze si provim i detyruar në nivelin gjuhësor B1; të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit; orientimin e vlerësimit që do të përfshijë 2 aftësi kryesore si dhe të japë orientime për specialistët që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore për gjuhën angleze si provim i detyruar. Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet ➔


Tirane, me 05/02/2018

**NJOFTIM**

***Drejtuar :*** Aksionereve te Shoqerise AKSIONI me seli ne rrugen Shaban Bardhoshi Tirane
***Lenda :*** Njoftim mbledhje Asambleja e Pergjithshme.

Ne baze te **LIGJI Nr.9901, datë 14.4.2008** PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE, **PJESA V** , SHOQËRITË AKSIONARE:

**Neni 135** : *Te drejtat dhe detyrimet*, pika 1 dhe 2,
**Neni 136**: *Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme*,pika2,
**Neni 137** : *Menyra e thirrjes se Asamblese te Pergjithshme*,pika 1 , 2, 3 dhe 4,
**Neni 138**: *Rendi I Dites* , pika 3,
**Neni 139**: *Mbledhja e asamblesë së përgjithshme dhe rendi i ditës*, pikat 1,2,3 ,

ju njoftojme se me kerkese te aksionereve **Kujtim Shkreli** dhe **Elvana Lula** , ne daten **1 Mars 2018**, ora 14.00, ne adresen e Selise Qendrore te shoqerise AKSIONI ne rrugen "Shaban Bardhoshi" Tirane, do te zhvillohet mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te shoqerise ,me rend dite si me poshte:

1. Analiza e shpenzimeve vjetore dhe taksat vendore.
2. Formalizimi I shoqerise.
3. Ndryshimi I statusit.
4. Te ndryshme.

Per cdo informacion apo propozim referojuni adreses se mesiperme te shoqerise.



## OBJEKTIVAT

Maturantëve iu del si detyrë që të aftësohen për objektivat e programit orientues si dhe të jenë të aftë të demonstrojnë arritjet e tyre në të gjitha llojet e teksteve. Në programin orientues për provimin kombëtar të Maturës Shtetërore 2018-të për lëndën letërsi dhe gjuhë shqipe janë përcaktuar të gjitha objektivat sipas linjave që duhet të arrihen nga nxënësi.

## GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Testi i Maturës Shtetërore 2018-të do të ketë në përbërje fragmente nga tekste të ndryshme (tekst tregimtar, tekst poetik, tekst dramatik, tekst bindës/argumentues, tekst përshkrues, tekst shpjegues, tekst informativ, tekst eseistik, tekst kulturologjik), jo patjetër të punuara në klasë. Pra, maturanti do të testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme.

## MATEMATIKA BËRTHAMË

Në linjën "Numri dhe veprimet me numrin" nxënësit duhet të fokusohen në bashkësitë numerike, veprime me numra si dhe matematika dhe financa e jetës së përditshme. Ndërsa në linjën e dytë "Algjebër" duhet të kenë parasysh shprehjet shkronjore dhe zgjidhjen e ekuacioneve, inekuacioneve, sistemeve; në një kohë që te "Matja" duhet të kenë parasysh matjet jo të drejtpërdrejta si dhe matjet me formula.

## GJUHA ANGLEZE B1

Kur flitet për tematikën kryesore në program nxënësit duhet që të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program (Sports and Entertainments, Travel Time, Environmental Issues, Modern Living, education, Personal and Social Life etc.) Ndërsa, për sa i përket përdorimit të gjuhës maturantët duhet të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore dhe leksikore që kanë trajtuar.

← të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, ku nxënësi në provim do të përballet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi, por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studiuar ndër vite. Kur flitet për tematikën kryesore në program nxënësit duhet që të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program (Sports and Entertainments, Travel Time, Environmental Issues, Modern Living, education, Personal and Social Life etc.) Ndërsa, për sa i përket përdorimit të gjuhës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore dhe leksikore që ata kanë trajtuar gjatë viteve të shkollës së mesme (passive voice, conditionals, reported speech, verb tenses, adverbs and adjectives comparisons, prepositions, connectors, countable and uncountable nouns; vocabulary related to entertainments, hobbies, food, celebrations, holiday destinations, types of travel, ëeather conditions, environmental issues, science, technology, fashion, etc) duke dalë nga konteksti i mësimeve ku këto probleme trajtohen. "Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa, e herë tipe ushtrimesh të hapura, ku më të spikaturat janë gap-fill, sentence transformation, matching, etj",-citohet në program. Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore.

Testi i gjuhës angleze me detyrim në nivelin gjuhësor B1 do të jetë i ndarë në 3 seksione ku testohen: të kuptuarit e një pjesë letrare ose jo letrare; përdorimi i gjuhës që përfshin aspektet më të rëndësishme gramatikore dhe leksikore trajtuar në vitet e shkollës së mesme si dhe të shkruarit. Në këtë të fundit, maturanti duhet të jetë i aftë të prezantohet me punë të tilla si email formal ose jo formal, letër formale ose jo formale, përshkrim, ritregim, përmbledhje apo ese përshkruese.

## GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

**Lista e veprave letrare për testim kombëtar**

**POEZI**

- Homeri "*Iliada*";
- Populli "*Këngë të epikës legjendare shqiptare*";
- N. Frashëri "*Lulet e verës*";
- De Rada "*Këngët e Milosaos*";
- Bajron "*Çajld Harold*";
- Fishta "*Mrizi i zanave*",
- Poradeci "*Lirika*";
- Migjeni "*Vargjet e lira*";
- Kadare "*Ca pika shiu ranë mbi qelq*".

**PROZË**

- Servantes "*Don Kishoti*";
- Hygo "*Katedralja e Parisit*";
- Pashko Vasa "*Bardha e Temalit*";
- Balzak "*Evgjeni Grande*"; "*Xha Gorio*";
- P. Marko "*Qyteti i fundit*";
- Kadare "*Kështjella*";
- Kamy "*I huaji*";
- Markes "*100 vjet vetmi*";
- Koliqi "*Tregtar flamujsh*".

**DRAMË**

- Eskili "*Prometeu*";
- Shekspir "*Romeo dhe Zhuljeta*", "*Mbreti Lir*", "*Makbeth*","*Hamleti*";
- Molier "*Mizantropi*";
- Ibsen "*Shtëpi kukulle*", "*Armiku i popullit*";
- Çajupi "*14 vjeç dhëndër*";
- Noli "*Izraelitë dhe filistinë*".

## MATEMATIKË BËRTHAMË

**Linjat ku do të bazohet testimi kombëtar i detyrueshëm i matematikës**

**1. Numri dhe veprimet me numri**

- *Bashkësitë numerike, veprime me numra*
- *Matematika dhe financa e jetës së përditshme*

**2. Algjebra**

- *Shprehjet shkronjore*
- *Zgjidhja e ekuacioneve, inekuacioneve, sistemeve*

**3. Matja**

- *Matje jo të drejtpërdrejta*
- *Matje me formula*

**4. Gjeometria**

- *Gjeometria në plan*
- *Gjeometria në hapësirë*
- *Vijat e gradës së dytë*

**5. Funksioni**

- *Kuptimi dhe paraqitja e funksionit*
- *Funksioni dhe limiti*

**6. Njehsimi diferencial e integral**

- *Derivati*
- *Njehsimi integral*

**7. Statistikë, probabilitet dhe kombinatorikë**

- *Statistikë*
- *Probabilitet*
- *Elemente të njehsimit kombinator*

## GJUHA ANGLEZE

**NOCIONET GJUHËSORE:**

- Expressing interests
- Giving personal information
- Recommending places
- Making suggestions (proposals, comments) on simple issues
- Suggesting and reaching a decision
- Expressing similiarities and diffrences
- Expressing likes and dislikes
- Making and responding to invitations
- Asking and answering personal questions
- Complaining and apologizing

**FORMAT E NDRYSHME TË TË SHKRUARIT:**

- email to a friend about a travel experience;
- a short review of a film, story, book, etc;.
- Letters or emails of recommendation;
- Narrative or descriptive letters or emails;
- Describing of a movie, concert, festival;
- A summary of a text, story, etc.

**FUNCTIONS/ NOTIONS**

- Describing places
- Describing past experiences and storytelling
- Describing feelings, emotions, attitudes
- Expressing opinions
- Expressing agreement/ disagreement
- Talking about films and books



Pronat e sekuestruara të tre vëllezërve Selaj në Lezhë





"Bizneset, vilat, makinat luksoze, janë përfituar nga aktiviteti i paligjshëm"

# Sekuestro pasurisë 1.4 mln euro bosit të kokainës në Itali, Valentin Selaj

## Policia: Pjesë e grupit kriminal dhe 2 vëllezërit e tij



I arrestuari Valentin Selaj



LEZHË

Një tjetër grup kriminal është shkatërruar nga policia e Lezhës në kuadër të operacionit "Forca e ligjit". Prokuroria vendosi sekuestro preventive për 15 pasuri të paluajtshme që kapin vlerën e 1.4 milionë eurove. Mësohet se këto pasuri i përkasin grupit kriminal të përbërë nga tre vëllezërit Selaj. Burime nga policia e prokuroria bënë me dije se dyshohet që grupi në fjalë e ka vendosur pasurinë me trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe shfrytëzim prostitucioni. Koka e grupit kriminal është Valentin Selaj, i njohur në media si i dashuri i moderatores Viola Spiro. Ai u arrestua pak kohë më parë në Itali si një nga bosët e trafikut të kokanës që vinte nga Amerika Latine. Ndërsa, dy të tjerët janë vëllezërit Parlind Selaj dhe Aleks Selaj, banues po në Lezhë. Tre vëllezërit, paratë e fituara nga trafiku i drogës dhe prostitucionit i kishin investuar duke ngritur biznese në Lezhë.

**SEKUESTRIMI I PASURISË**

Burime nga policia e Lezhës pohuan se në vijim të hetimeve të procedimit penal të vitit 2017, ku Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar procedimin penal për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale, apo të veprimtarisë kriminale" u ekzekutua vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë që vendosi sekuestro preventive, mbi pasuritë e grupit kriminal. Ndaj grupit u vendos sekuestro preventive për 15 pasuri të paluajtshme dhe konkretisht: 7 ambiente biznesi, me sipërfaqe rreth 1100 m2 si Hotel, Bar, Restorant; 4 ambiente banimi, me sipërfaqe rreth 1000 m2 (apartamente, vila); 4 parcela tokë arë, me sipërfaqe totale rreth 22900 m2; 9 automjete luksoze. Pasuritë e sekuestruara kapin vlerën totale rreth 1,450,000 euro. Sipas bluve, këto pasuri rezultojnë të regjistruara në emër të shtetasve: P.S., 40 vjeç, banues në Shëngjin, Lezhë; V.S., 29 vjeç, banues në Rrilë, Lezhë, i arrestuar nga policia e Firences në Itali, si drejtues i një grupi kriminal që merrej me trafikimin e lëndëve narkotike nga Amerika në Itali dhe shfrytëzimin për prostitucion; A.S., 35 vjeç, banues në Shëngjin, Lezhë, i arrestuar në vitin 2008 nga policia e Trentos në Itali si pjesëtar i një grupi kriminal që merrej me trafikimin e lëndëve narkotike nga Holanda drejt Italisë, në kuadër të operacionit "Apuleio" dhe në vitin 2010 u dënua me 4.6 vite burg. Hetimi për këtë grup kriminal, nisi bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative nga Sektori për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë. Në janar 2018, pas një hetimi disa mujor me metoda speciale të hetimit, në bashkëpunim me prokurorinë u dokumentua veprimtaria kriminale dhe pasuritë e dyshuara se rrjedhin nga aktiviteti kriminal. Policia i sugjeroi prokurorisë vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e identifikuara në pronësi të pjesëtarëve të grupit kriminal dhe familjarëve të tyre.

**OPERACIONI "FORCA E LIGJIT" NË LEZHË**

- GRUPI KRIMINAL

| | |
|---|---|
| 1- Valentin Selaj | 28 vjeç |
| 2- Parlind Selaj | 40 vjeç |
| 3- Aleks Selaj | 35 vjeç |

15 PASURITË E VENDOSURA NË SEKUESTRO

- 7 ambiente biznesi, me sipërfaqe rreth 1100 m2 si Hotel, Bar, Restorant;
- 4 ambiente banimi, me sipërfaqe rreth 1000 m2 (apartamente, vila);
- 4 parcela tokë arë, me sipërfaqe totale rreth 22900 m2;
- 9 automjete luksoze.

## Trafiku i drogës nga Amerika në Itali, ja si u arrestua Valentin Selaj

Valentin Selaj është arrestuar tre muaj më parë në Itali si një nga bosët e trafikut të kokainës që vinte nga Amerika Latine. Ai u vu në pranga pas hetimeve të kryera nga dy prokurorë holandezë. Më pas, policia italiane dhe ajo e Holandës finalizuan një megaoperacion antidrogë më 16 nëntor të vitit që shkoi, duke vënë në pranga 7 persona që trafikonin kokainë nga Amerika e Jugut, në Roterdam e më pas në Firence. Policia italiane publikoi edhe pamjet e operacionit, ku mes të arrestuarve ishte edhe 28-vjeçari nga Lezha, Valentin Selaj, i cili rezultoi të ishte i dashuri i moderatores së njohur shqiptare, Viola Spiro. Lajmi u bë publik fillimisht nga gazeta italiane "La Nazione", e cila nuk dha shumë detaje, por në faqen e saj të parë publikoi një foto të shqiptarit Valentin Selaj bashkë me prezantuesen Viola Spiro. Sipas gazetës italiane, i dashuri i Viola Spiros kishte një rol shumë të rëndësishëm në grupin e trafikut të drogës, pasi siguronte kokainën nga Amerika e Jugut në Firence, përmes Holandës.

SHKURT

### Sherri për pronën mes 2 familjeve, plagosen burrë e grua

DIBËR - Një konflikt i kahershëm pronësie mes dy familjeve në Dibër për pak sa nuk ka përfunduar në tragjedi. Mësohet se gjatë konfliktit ku u përfshinë 8 persona u plagosën dy prej tyre. Bëhet fjalë për bashkëshortët Behar dhe Vasije Balla, të cilët përfunduan në spital. Ngjarja ka ndodhur në fshatin Gjoricë mes familjeve Balla dhe Cani. Pjesëtarët e dy familjeve në fjalë janë përleshur me mjete të forta. E plagosura, Vasije Balla dje pohoi për "GSH" se u sulmuan nga familja tjetër pas sherrit për portën e murit rrethues të banesës së saj. Ajo tha se nuk ka denoncuar pjesëtarët e familjes Balla në polici, pasi ka frikë për djalin e saj 13-vjeçar dhe bashkëshortin që e ka të sëmurë.

### Mori peng e dhunoi 19-vjeçarin, bie në pranga kryeplaku

KORÇË - Kryeplaku i fshatit Biranj ka përfunduar në pranga, pasi akuzohet për "Rrëmbim ose mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese". Sipas policisë së Korçës, 36-vjeçari Bledi Nurçe ka dhunuar një 19-vjeçar, për të cilin dyshonte se kishte kryer një grabitje. "Më datë 05.02.2018, Bledi Nurçe, ka shkuar tek banesa e shtetasit K.R, 19 vjeç e ka goditur fizikisht dhe i ka kërkuar këtij të fundit, të dilte jashtë banese me pretendimin se e kërkonte policia, për ta pyetur në lidhje me vjedhjen e disa pajisjeve elektroshtëpiake në banesën e shtetasit L.M., 45 vjeç, ngjarje e ndodhur më datë 30.01.2018. Pasi kanë shkuar tek banesa ku kishte ndodhur vjedhja, Bledi Nurçe sërish ka ushtruar dhunë fizike ndaj shtetasit K.R, me pretendimin se ky i fundit ishte autor i kësaj vjedhje dhe më pas e ka lënë të lirë. Po punohet për dokumentimin e kësaj ngjarjeje, ndërsa materialet në ngarkim të 36-vjeçarit i kaluan Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Korçë për veprime të mëtejshme", thuhet në njoftimin e policisë.

VIP Pages
Suplement
E mërkurë 7 Shkurt 2018 GAZETA SHQIPTARE

## ILDA BEJLERI

braktis "Digitalb"? Ja ku do ta shohim së shpejti



## Moderatorja e njohur, me projekte të reja. Kësaj radhe jo në Shqipëri,




## Harrojeni Linda Rein, kunata e saj e re do t'ju lërë pa mend













# Çiftet që "lindën" në "Big Brother" në njëmbëdhjetë vite

*Ndarje apo martesa? Kush i mbijetoi sfidës pas daljes nga reality show*

## Nga Olsi e Noçja, te Fotinia e Danjeli, ja cilët janë "dashuritë" që nisën brenda shtëpisë

# Çiftet që "lindën" në " Big Brother" ndër vite

## *Ndarje apo martesa? Kush i mbijetoi sfidës pas daljes nga reality show*

Pamela Aliaj

Kanë kaluar plot njëmbëdhjetë vite që prej nisjes së një nga edicioneve më të ndjekura nga gjithë shqiptarët në mbarë vendin, "Big Brother Albania". Ndër vite nuk kemi se si të harrojmë shumë nga batutat apo zënkat e ndodhura brenda shtëpisë më të famshme në Shqipëri. Ende shumë prej personazheve i kujtojmë, sepse disa prej tyre vazhdojnë të mbeten pjesë të televizionit ndërsa shumë të tjerë janë "zhdukur" pa lënë shumë gjurmë në mediat rozë. Por ajo që duam të veçojmë e të sjellim në rikujtesë janë pikërisht çiftet e krijuara brenda kësaj shtëpie, e cila ka shërbyer për shumë nga personazhet aty si katalizator i dashurisë. Për fat të keq shumë nga këto çifte të krijuara s'mundën ta kurorëzojnë dashurinë e tyre për një kohë të gjatë, duke u ndarë brenda një kohe të shkurtër. Ndërkohë që "kampion" mban çifti i njohur i "Big Brother 4" Neda dhe Ogreni, të cilët vazhdojnë ende së bashku dhe kanë edhe një fëmijë. Gjithashtu, të freskët kemi edhe çiftin e parë që u martua brenda shtëpisë, Danjeli dhe Fotinia, të cilët vazhdojnë ende historinë e tyre të dashurisë edhe jashtë shtëpisë, ku të gjithë ne jemi duke pritur me padurim edhe dasmën e tyre. Ndërkohë më poshtë ju risjellim në kujtesë çiftet që u krijuan dhe u ndanë më pas në "Big Brother Albania", ndër vite:

## "Big Brother 1"

### Olsi dhe Noçja (Najada)

Ata ishin të parët që nisën një histori dashurie në "Big Brother" ishin Najada, (e quajtur ndryshe Noçja) dhe Olsi. Ai kishte lënë jashtë të dashurën e tij, me të cilën i dha fund lidhjes kur njohu Najadën. Pavarësisht së çifti pati disa ulje-ngritje në historinë e tyre të dashurisë, lidhja e tyre përfundoi disa kohë më vonë.



### Ina dhe Poli

Ata ishin një ndër çiftet e para që u krijuan brenda mureve të shtëpisë së "Big Brother 1". Edhe pse Ina, pak më e madhe në moshë se Poli, u eliminua më herët nga loja, ajo i shprehu dashurinë publikisht gjatë një surprize live. Poli shkoi në finale duke dalë në vendin e pestë, e pas përfundimit të edicionit vazhduan lidhjen edhe jashtë. U përfol madje se Ina edhe kishte ngelur shtatzënë, diçka që do ta vendoste Polin mes 'dy zjarresh', një mundësie shumë të mirë për të punuar në Spanjë dhe asaj për të krijuar familje me fëmijën e ardhshëm. Por atë kohë, një ditë pasi Ina e kishte pohuar këtë lajm për një gazetë, ditën tjetër ajo e mohoi kategorikisht shtatzaninë. Poli u largua në Spanjë dhe të dy i dhanë fund lidhjes.



## "Big Brother 2"

### Arjoni dhe Anjeza

Një histori jo me shumë bujë do të ishte edhe ajo midis Arjonit dhe Anjezës. Çifti u lidh dhe u nda brenda shtëpisë së "Big Brother", pa komentuar arsyet e ndarjes. Anjeza sot ka nisur një histori të re dashurie ndërsa Arjoni nuk ka dashur ta bëjë publike jetën e tij private.



## "Big Brother 3"

### Rezarta dhe Jetmiri

Lidhja mes konkurrentes nga Kosova, Rezartës dhe fituesit të edicionit të tretë, Jetmirit ndoshta nuk pati bujën e madhe të lidhjeve të tjera, për shkak edhe të intervistave jo të shumta. Pas disa muajsh heshtje dhe asnjë shfaqje mediatike të çiftit në faqet e shtypit rozë, çifti deklaroi se ishin ndarë. Kjo ndarje erdhi disa muaj pasi ata kishin nisur një bashkëjetesë në Tiranë, e cila nuk funksionoi.



### Bertina dhe Erjoni



Historia e tyre e dashurisë nisi brenda shtëpisë së famshme për të vazhduar edhe jashtë saj. Ata dukeshin se ishin çifti perfekt, por mesa duket nuk ishte e gjatë lidhja e tyre jashtë mureve të shtëpisë së famshme. Bertina dhe Erjoni vendosën t'i japin fund marrëdhënies së tyre pas afro dy vitesh.

### Seldi dhe Domenika

Lidhja mes Seldit dhe Domenikës nuk zgjati shumë pas daljes nga shtëpia. Pasi i dha fund historisë së tyre, çifti bëri një sërë deklaratash në mediat sociale mbi shkaqet e ndarjes.



## "Big Brother 4"

### Marjeli dhe Mirjeta

Të lidhur brenda shtëpisë, Marjeli dhe Mirjeta nuk e vazhduan gjatë lidhjen e tyre. Ai u largua drejt Italisë, ndërsa Mirjeta vazhdoi jetën e saj në Londër. Kjo e fundit e harroi historinë në shtëpinë e "Big"-ut dhe u martua me një tjetër djalë.



### Ogreni dhe Neda



Ata kanë qenë një nga çiftet që u sulmuan shumë brenda shtëpisë e madje edhe për lidhjen e tyre, por ata arritën që t'u demonstronin të gjithëve të kundërtën. Ndërkohë që tashmë janë prindër të një vogëlushi. Ogreni dhe Neda ishin të vetmit që vazhduan lidhjen edhe jashtë shtëpisë së famshme dhe janë çifti me lidhjen më afatgjatë të këtij spektakli.

### Ervini dhe Ermela

Ermela, fituesja e "Big Brother Albania 4" do të niste një histori me Ervinin, po konkurrent të atij edicioni. Pas daljes, çifti nisi bashkëjetesën dhe pavarësisht ndarjeve dhe rilidhjeve pohuan se historia e tyre kishte marrë fund.



### Alma dhe Çimi



Ata u njohën në shtëpinë e "Big Brother", ku edhe ra në sy një pëlqim mes tyre, por nuk shkuan më tej. Pas daljes, Alma dhe Çimi nisën një histori dashurie dhe jo vetëm kaq, por u zhvendosën në Itali për t'u bërë prindër të një vajze. Thuhet se çifti i ka dhënë fund marrëdhënies së tyre.

## "Big Brother 5"

### Ermali dhe Françeska

Pas daljes nga shtëpia, çifti pohonte nëpër gazeta se lidhja e tyre ishte më e bukur jashtë, e madje edhe se familjet e tyre ishin takuar. Por çfarë ndodhi që gjërat nuk shkuan ashtu siç duhet? Mediat rozë flisnin se mes çiftit pati një tradhti. Lidhja mes Ermalit dhe Françeskës zgjati vetëm pak javë pas daljes nga shtëpia e "Big Brother". Ndërkohë që tani flitet se Françeska është lidhur me djalin e famshëm të biznesmenit Geci. Ndërsa Ermali është tashmë i martuar që prej gushtit të 2016.



## "Big Brother 6"

### Anaidi dhe Joana

Ditën e nesërme pas daljes nga shtëpia e "Big Brother Albania 6", fituesi Anaid Kaloti i habiti të gjithë me deklaratën e tij: "Jam single". Ai tha se lidhja me Joanën kishte marrë fund. Joana u kthye te partneri i saj, e ndarë për shkak të lidhjes me Anaidin, ndërsa ky i fundit ka nisur një histori dashurie me një modele të njohur. Ndërkohë që u përfol më vonë për lidhjen e tij me modelen e famshme të OTR, Oriola Marashin, lidhje kjo që nuk zgjati shumë.



## "Big Brother 7"

### Xhuli dhe Arditi

Xhuli dhe Arditi u lidhën brenda shtëpisë, por tashmë ata nuk janë më bashkë. Të dy ish-konkurrentët jepnin deklarata të shumta kundër njeri-tjetrit nëpër gazeta, por asnjëherë nuk u kuptua arsyeja e vërtetë e ndarjes së tyre.



## "Big Brother 9"

### Sidrita dhe Ervini

Nuk ka kaluar as një javë që nga dalja e tyre nga "Big Brother", por duket se çifti i ka dhënë fund. Flasim për dy ish-banorët e "Big Brother", Sidritën dhe Ervinin, të cilët nuk e zgjatën shumë lidhjen e tyre jashtë shtëpisë. Në rrjetet e tyre sociale janë zhdukur të gjitha fotot e përbashkëta, duke fshirë raportin e shkurtër që kishin. Edhe pse u duk si një histori e bukur dashurie me ndjenja dhe shumë pasion brenda, jashtë nuk rezistojë shumë gjatë. Të dy kanë vijuar me jetën e tyre, duke lënë pas marrëdhënien e tyre, por pse jo dhe eksperiencën e (hidhur) në "Big Brother".



### Damiano dhe Armela

Ai ka treguar se është ndarë nga Armela dhe për këtë gjë fajtore është Donjeta, ish-banore e këtij formati po ashtu. Në shkrimin që ka lënë ai ka thënë se Donjeta dhe motra e saj pas takimit që kishin në Prishtinë me Damianon, përmes një videoje, kanë fyer dhe ofenduar rëndë Armelën dhe komunitetin e saj, prandaj kjo gjë çoi në ndarjen e tashmë ish-çiftit. Po ashtu, Damiano ka thënë se mirësia që ai ka bërë duke u munduar që t'i rregullojë raportet e këqia mes Donjetës dhe Armelës iu kthye për të keq, pasi ndikoi në lidhjen e tij me Armelën. Përmes fjalëve, Damiano kërkoi falje publike ish-të dashurës së tij.



### Gerta dhe Denisi

Gerta Shino, ish-banorja e "Big Brother", e cila ishte ?ift me Denisin, sapo u skualifikua nga gara, lajmëroi se edhe lidhja e ?iftit mori fund me daljen prej andej. Edhe pse u përfol se lidhja mund të funksiononte jashtë, duket se Gerta e ka ndarë mendjen dhe Denisi nuk mund të jetë më shumë se një mik për të.



## "Big Brother 8"

### Xhensila dhe Fatjoni

Duket se çiftet e "Big Brother Albania 8" nuk arritën të mbijetonin pas daljes nga shtëpia më e ndjekur në Shqipëri. Pas ndarjes së Alba me Diedonin, ka qenë Fatjoni, i cili përmes një statusi në profilin e tij në "Facebook" është shprehur se marrëdhënia e tij me Xhensilën ka përfunduar. Lajmin e ka bërë të ditur në faqen e tij opinionisti Olti Curri, i cili thekson se vetëm pak çaste më vonë statusi është fshirë. Tashmë Xhensila vijon jetën e saj, duke mos iu shkëputur ekranit të jetë gjithnjë e më tepër aktive "single".





### Alba dhe Diedoni

Ata pasi krijuan lidhjen brenda shtëpisë, e vazhduan edhe pasi dolën jashtë, duke qëndruar e shijuar dashurinë së bashku. Madje ata ishin edhe në pushime së bashku. Por kjo nuk zgjati shumë. Çifti është ndarë dhe lajmi është konfirmuar nga vet Alba, përmes një statusi në "Facebook". Edhe pse ka lajmëruar fansat për ndarjen e tyre, ajo nuk ka treguar shkakun e ndarjes.

### Veseli dhe Tea

Ata ishin ndër çiftet më të përfolura të media ve që nga dalja nga 'Big Brother Albania', ndërsa pas shumë fjalëve vetë Veseli konfirmon se ata përfundimisht janë ndarë. Veseli thotë se kjo ndarje nuk ka të bëjë me tradhti nga asnjëra palë, por thjesht mospërputhje e vazhdueshme mes tyre ka bërë që ata të marrin këtë vendim. Ai ka kërkuar që fansat dhe njerëzit në përgjithësi të respektojnë vendimin që kanë marrë, pa pasur nevojë të shpifin gjëra.





### Olsi dhe Fjorentina

Olsi dhe Fjorentina kanë qenë një çifti shumë i komentuar brenda spektaklit "Big Brother Albania 9". Ky çift mesa duket i kanë dhënë fund njëherë e mirë lidhjes së tyre. Lajmin për këtë gjë e ka bërë të ditur vet Fjorentina përmes një fotografie të publikuar në "Instagram", në të cilën shkruhej: "Po, unë jam beqare". "Për të gjithë ato që më kanë mërzit duke më pyetur, ja përgjigja, faleminderit që me ndiqni dhe më mbështesni", ka shkruar ish-banorja në përshkrimin e fotografisë në Instagram.

### Xheni dhe Bernardi

Dyshja në fjalë i kanë dhënë fund lidhjes disa mujore, lidhje të cilën e kishin filluar brenda shtëpisë. Lajmin për këtë ndarje e ka konfirmuar edhe vet Xheni përmes një statusi të publikuar në "InstaStory", të cilin më pas e fshiu. Nuk dihen shkaqet që kanë çuar dyshen deri në këtë ndarje, megjithatë ata janë cilësuar si një prej çifteve më të ëmbla gjatë kohës sa ishin bashkë.



### Dona dhe Musa

Në një postim një "Instastory", Dona shkruan "Kaq ishte, faleminderit për besimin të gjithëve, ju falënderoj me zemër", një mesazh që njofton ndarjen e tyre. Duket se largësia ka bërë të veten. Në postimet e tyre të fundit Dona dhe Musa kanë treguar një jetë, e cila ishte larg njëri- tjetrit, secili në punën e tij. Prej kohësh është përfolur për një ndarje të mundshme të tyren, por mesa duket ky postim e ka konfirmuar si lajm.





### Danjel dhe Fotini

Çifti fitues i edicionit të nëntë të "Big Brother" kanë preferuar të qëndrojnë larg vëmendjes mediatike. Martesa e Danjelit dhe Fotinisë brenda shtëpisë së "Big"-ut bëri shumë persona dyshues duke menduar se kjo ishte një zgjedhje për të dalë fitues apo për show. Por koha kaloi dhe duket se u vërtetoi të gjithëve të kundërtën. Edhe në postimin në të fundit në "Instagram" ata dukem mjaft të lumtur me njëri-tjetrit. Çifti ka njoftuar se në verë do të realizojë një dasmë me familjarët e tyre, pasi planet e më parshme u shtynë për shkak të gjendjes së tyre ekonomike. Një tjetër rast kur dashuria e vërtetë, edhe pse e krijuar brenda një reality show, triumfon.

Ajo arrin të jetë gjithnjë në qendër të vëmendjes me postimet e shumta që bën, duke nxjerrë në pah linjat e saj seksi, apo edhe me pjesëmarrjet e ndryshme në evente të rëndësishme. Ajo arrin gjithnjë të na mahnitë me punët e ndryshme që bën duke ndërmarrë përsipër pasionet e saj. Aurela Hoxhën e kemi njohur si modele, 'businesswoman', aktore së fundmi, ku na ka treguar se vetëm talenti nuk mjafton për të qenë e suksesshme. Duhet edhe shumë punë e këmbëngulje për të mbërritur në "destinacionin" e dëshiruar, që për të nuk ka dyshim që është suksesi dhe fama. Prej kohësh Aurela Hoxha ndodhet në Barcelonë dhe përmes fotos së fundit të publikuar në "Instagram", ajo na le të kuptojmë se këtë herë nuk bëhet fjalë për pushime ekzotike, relaks, që ajo i shijon pa stinë, thuajse në çdo periudhë të vitit. Është fjala për diçka profesionale, një projekt i ri kinematografik. Në foton e fundit të postuar, ajo ka bërë "check in" në "Belledejour Studio", kompani e njohur kjo në prodhimin e filmave. Ajo shfaqet me dy persona të tjerë, që me shumë mundësi janë pjesë e kësaj studioje të njohur. Ndërkohë që më parë, ajo u shfaq si aktore në filmin "Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna 3", rol për të cilin u komentua jo pak. Në foton e postuar vihet re mbishkrimi "Soon" (së shpejti). Kushedi se ç'supriza na ka rezervuar...





## Aurela Hoxha na befason sërish, këtë herë në Spanjë ajo…

## Harrojeni Linda Rein, kunata e saj e re do t'ju lërë pa mend






Prej më shumë se dy javësh transgjinorja e njohur Linda Rei ka bërë të ditur ndarjen e saj nga i fejuari zviceran. Nëpërmjet statuseve të njëpasnjëshme në "Instagram", ka qenë vetë ajo që i ka prezantuar ndjekësit e saj me një mashkull tjetër, të cilin e ka apro-vuar më vonë që është i dashuri i ri. Por nuk është mjaftuar me kaq. Ajo ka dashur të prezantojë edhe pjesën tjetër të familjes, duke nisur me kunatën. Në një status në "Instastory" ajo prezanton bionden simpatike, të cilën e quan "kunata ime e re", e cila duket se ngjan shumë me Lindën. Presim të prezantojë pjesën tjetër të familjes tani. Mesa duket, Linda e ka marrë shumë seriozisht me djaloshin me mjekër. Një tjetër fejesë në horizont?




Prej kohësh ajo nuk është më pjesë e ekraneve ku sipas saj, në intervistën e fundit të dhënë për "Gazeta Shqiptare" ka thënë se është duke punuar për një projekt të ri. Dhe nuk vonoi shumë, kur Einxhel Shkira postoi në faqen e saj në "Instagram" një foto ku shihej në krah të dy femrave të tjera në Prishtinë. Në foto nuk ka harruar të vendosë mbishkrimin "Diçka po zien". Të jetë ajo që të gjithë jemi duke pritur? Kësaj radhe do të nisë një emision në Kosovë? Mbetet ende e pazbuluar.

## Moderatorja e njohur, me projekte të reja. Kësaj radhe jo në Shqipëri,

## Ilda Bejleri braktis "Digitalb"? Ja ku do ta shohim së shpejti

Ajo është padyshim një nga moderatoret më seksi të "Supersport" në "Digitalb". Mesa duket, ajo ka vendosur të mos ndalet me aq, por të guxojë të shfaqet edhe diku tjetër. Ilda Bejlerin duket se krah studios sportive do të shikojmë edhe në një "reality show". Së shpejti në ekranet televizive to të startojnë spektakle të reja, ku ndër më të përfolurat është "Big Brother VIP" si dhe "Dancing With the Stars". Me anë të postimit të fundit Ila ka lënë të kuptohet se do të jetë pjesë e spektaklit të kërcimit, por nuk ka dhënë detaje se për çfarë bëhet fjalë konkretisht. Së shpejti do të marrim edhe përgjigjen.







Nuk ka se si të jetë ndryshe për një femër kaq ndjellëse sa Françeska, e cila nuk harron të bie në sy e të tërheqë vëmendjen e fansave me postimet e saj në "Instagram". Kësaj radhe ajo ka ndezur sërish 'zjarrin' me postimin të fundit. E veshur me bikini të kuqe dhe e zhytur në një pishinë dimërore, ish-banorja e "Big Brother", nuk mund të ishte më sensuale. Postimet e saj provokuese të njëpasnjëshme nuk mbeten jashtë vë-mendjes. Të tjera presim nga Françi, të shohim si do të provokojë këtë radhë!

## Françeska do t'ju lërë pa fjalë, kësaj radhe shfaqet e lagur

Prokuroria: Ja si i përgatisnin dozat e kokainës 2 nipat e Markut dhe banakieri

# Lihen në burg 7 pjesëtarët e grupit "Kokaina", Helidon Marku: Nuk kam lidhje me drogën

## "Lokali ka kamera sigurie, gjithçka është e filmuar"

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër ka dhënë "arrest me burg" për 7 personat që u arrestuan të shtunën që shkoi gjatë operacionit të koduar "Kokaina", në kuadër të nismës "Forca e Ligjit" të Policisë së Shtetit. Bëhet fjalë për shtetasit Helidon Marku, 42 vjeç i dënuar disa herë për vepra të rënda penale; Indrit Tagani, 30 vjeç, banues në Shkodër; Erjon Zekaj, 31 vjeç, banues në Koplik i Sipërm, Malësia e Madhe; Saimir Arçi, 31 vjeç, banues në Shkodër; Aldo Vruçaj, 28 vjeç, banues në Shkodër dhe Aleksandër Matoja, 31 vjeç, banues në Shkodër.

Ndërsa, është dhënë masë më lehtësuese për Kristjan Ujkaj, 31 vjeç banues në Shkodër. Togat e zeza vendosën ndaj tij masën e sigurisë "arrest me burg" për 30 ditë. Policia e Shkodrës dhe e Durrësit i prangosi 7 personat mësipërm, pasi dyshohen se në lokalin me muzikë live, "Sampa" në fshatin Beltojë të Shkodrës ofronin drogë të llojit kokainë për klientët. Ndërkohë që blutë sekuestruan në Durrës, në mjetin e Indrit Taganit 2.237 kg kokainë. Prokuroria i akuzon 7 pjesëtarët e grupit kriminal për veprat penale "Prodhim, mbajtje e shitjes së narkotikëve", përshtatje e lokalit për përdorim droge, kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin qoftë për transportimin e lëndës së fortë narkotike, por edhe lejimin e përdorimit të drogës në lokalin e natës. Në sallën e gjyqit, gjatë masës së sigurisë, përpara gjyqtares Izabela Radovani të akuzuarit, por edhe avokatët mbrojtës kanë pretenduar se nuk kanë lidhje me atë për çfarë akuzohen.

**DËSHMITË E GRUPIT "KOKAINA"**

Helidon Marku, i cili kishte me qira lokalin "Sampa" ka deklaruar dje se ai nuk ka lidhje me drogën. "Unë kam një muaj pa shkuar fare tek lokali dhe nuk e kam idenë se çfarë ka ndodhur. Unë kam prindërit e sëmurë dhe kam kohë pa shkuar në lokal. Pastaj edhe sikur të kem qenë, lokali ka kamera sigurie dhe gjithçka është e filmuar. Si mund ta lejoj unë drogën, kur aty kam kamera?! Është e pamundur. S'kam lidhje me këtë punë", tha Marku. Avokati mbrojtës i Helidon Markut, Artan Reçi pretendoi se arrestimi është i paligjshëm, ndërsa kërkoi lehtësim të masës së sigurisë. I akuzuari Aldo Vruçaj, i cili është nipi i Helidon Markut tha se punonte në lokal si kamarier. "Unë kam qenë thjesht kamarier në atë lokal. Aty kam shkuar për të punuar tek daja dhe nuk kam asnjë lidhje me drogën apo akuzat ndaj meje. Kam qenë thjesht një punonjës dhe nuk e di se kishte drogë në lokal", është shprehur 28-vjeçari në sallën e gjyqit. Kristjan Ujkaj, nipi tjetër i Helidon Markut pohoi se sapo është kthyer nga emigrimi. "Unë me 31 dhjetor kam ardhur nga Italia në Shqipëri. Në Shkodër kam hapur një pastiçeri për të punuar dhe s'kam asnjë lidhje me drogën. Po të ishte ashtu, s'do kisha hapur pastiçerinë për t'u lodhur gjithë ditën. Unë sapo kam ardhur nga Italia dhe nuk ia kam idenë se çfarë akuzohem", është shprehur 31-vjeçari. Aleksandër Matoja, i cili njihet si një shok i nipave të Helidon Markut dhe që prej disa kohësh punonte në lokalin "Sampa" si banakier mohoi akuzat. "Unë kam qenë thjesht banakier. Unë nuk kam se si ta përdor lokalin e dikujt tjetër, pra që nuk ësh-



Indrit Tagani



Aldo Vruçaj



Erjon Zekaj



Saimir Arrçi

të i imi për drogë apo gjëra të tilla. Unë kam qenë aty thjesht për të punuar si banakier dhe asgjë më shumë". Indrit Tagani për prokurorinë është ndër më të rëndësishmit që është arrestuar, për shkak se në mjetin e tij policia e Durrësit gjeti 2.237 kg drogë e dyshuar si kokainë. Në momentin e arrestimit Idrit Tagani ka qenë në mjet bashkë me shtetasin Erjon Zekaj. Ky i fundit ka qenë duke drejtuar mjetin për shkak se Indrit Tagani pretendon se nuk ka pasur patentë. "Unë nuk kam pasur patentë dhe kam marrë Erjonin për të nisur makinën. Unë s'kam lidhje me drogën dhe as asgjë tjetër". Avokati mbrojtës i Indrit Taganit, Ardjan Brunga ka cilësuar si të ligjshëm arrestimin, por në sallën e gjyqit ka kërkuar masën lehtësuese "arrest shtëpie". "Kërkoj arrest shtëpie, sepse prokuroria nuk e argumentoi rrezikshmërinë për klientit tim, pra nuk është i rrezikshëm. Po ashtu, nuk ka mundësi largimi jashtë kufijve, sepse kufijtë e Shqipërisë janë të garantuar. Po ashtu, nëse lihet me arrest shtëpie për klientin tim nuk ndryshon asnjë provë nga prokuroria, ndërsa ende nuk ka përfunduar akti i plotë i ekspertizës për atë që pretendohet", u shpreh avokati Brunga. Nga ana e tij, Erjon Zeka ka deklaruar se ka qenë thjesht shofer dhe se nuk ka asnjë ide për drogën. Saimir Arçi, që u arrestua teksa ndodhej i vetëm në mjetin e tij, pas mjetit ku ishin shtetasit Indrit Tagani dhe Erjon Zekaj ka mohuar se është pjesë e këtij grupi të drogës. Ndryshe nga sa kanë pretenduar të akuzuarit dhe avokatët e tyre, prokurori i çështjes, Albert Murçaj ka bërë të qartë në sallën e gjyqit se kemi të bëjmë me një grup prej shtatë personash, të cilët kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin për transportin e drogës dhe lejimin e përdorimit të saj në mjediset e lokalit "Sampa". Prokurori tha se ka prova të mjaftueshme pas përgjimeve 3-mujore që provojnë se këta shtetas kanë bashkëpunuar bashkë. Helidon Marku që kishte marrë me qira lokalin, sipas organit të akuzës ka dijeni për përdorimin e drogës dhe është bashkëpunëtor. Po ashtu, banakieri Aleksandër Matoja dhe dy nipat e Helidon Markut, Aldo Vruçaj dhe Kristjan Ujkaj janë marrë me përgatitjen e dozave të kokainës në lokal. Po ashtu, Indrit Taganin, Erjon Zekajn dhe Saimir Arçin, prokuroria i cilëson si persona që po transportonin drogën dhe bashkëpunëtorë me pjesën tjetër e të arrestuarve.

**HELIDON MARKU**

"Unë kam një muaj pa shkuar fare tek lokali dhe nuk e kam idenë se çfarë ka ndodhur. Unë kam prindërit e sëmurë dhe kam kohë pa shkuar në lokal. Pastaj edhe sikur të kem qenë, lokali ka kamera sigurie dhe gjithçka është e filmuar. Si mund ta lejoj unë drogën, kur aty kam kamera. Është e pamundur. S'kam lidhje me këtë punë', tha i akuzuari Helidon Marku. Avokati mbrojtës, Artan Reçi pretendoi se arrestimi është i paligjshëm, ndërsa kërkoi lehtësim të masës së sigurisë.

**ALDO VRUÇAJ**

I akuzuari Aldo Vruçaj, i cili është nipi i Helidon Markut tha se punonte në lokal si kamarier. "Unë kam qenë thjesht kamarier në atë lokal. Aty kam shkuar për të punuar tek daja dhe nuk kam asnjë lidhje me drogën apo akuzat ndaj meje. Kam qenë thjesht një punonjës dhe nuk e di se kishte drogë në lokal", është shprehur dje 28-vjeçari në seancën gjyqësore, ku u vendos masa e sigurisë për shtatë të pandehurit e grupit "Kokaina".

**KRISTJAN UJKAJ**

Kristjan Ujkaj, nipi tjetër i Helidon Markut pohoi dje në sallën e gjyqit se sapo është kthyer nga emigrimi. "Unë më 31 dhjetor kam ardhur nga Italia në Shqipëri. Në Shkodër kam hapur një pastiçeri për të punuar dhe s'kam asnjë lidhje me drogën. Po të ishte ashtu, s'do kisha hapur pastiçerinë për t'u lodhur gjithë ditën. Unë sapo kam ardhur nga Italia dhe nuk ia kam idenë se për çfarë akuzohem", është shprehur 31-vjeçari.

**PLAGOSJA NË LOKAL**

Më 3 shtator të vitit të kaluar, në lokalin me muzikë live "Sampa" u plagos rëndë 21-vjeçari Edmir Nilaj, i cili pas afro 4 muajsh u nda nga jeta. Në lidhje me këtë ngjarje, policia akuzon Admir Dekovin, i cili ishte truprojë në atë lokal. Përpara kësaj plagosjeje me pasojë vdekjen kishte ndodhur një tjetër sherr mes disa shtetasve nga Lezha dhe Shkodra, të cilët kanë goditur njëri-tjetrin.

## Sekuestrohen 209 kg drogë në 5 operacione, arrestohen 6 shqiptarë



**GREQI -** Policia greke dje ka sekuestruar në total 209 kg 598 gr marijuanë në 5 operacione antidrogë. Mësohet se gjatë kontrollit të një automjeti në Larisa u sekuestruan 66 kg 618 gr marijuanë, ndërsa u arrestua drejtuesi i mjetit (shqiptar 41vjeç, pa leje drejtimi). Në lidhje me këtë rast u shpall në kërkim pronari i mjetit, (grek 41 vjeç). Në një operacion të zhvilluar në një zonë pyjore të Selanikut u sekuestruan 27.5 kg marijuanë, ndërsa në pranga përfundoi një shqiptar 28-vjeçar dhe tre grekë, mes të cilëve një femër. Në operacionin e zhvilluar në Parapotamo, Igumenicë është ndaluar një mjet që ishte ngarkuar në kufirin e gjelbër. Policia sekuestroi në këtë mjet 68. 8 kg marijuanë, ndërsa ranë në pranga drejtuesi i mjetit, grek 37 vjeç dhe pasagjeri shqiptar 27 vjeç. Në operacionin e zhvilluar në Kato Lavdhani, Janinë u arrestua një shqiptar 34-vjeçar që po mbante në ruajtje një sasi droge që ishte kaluar nga kufiri gjelbër dhe ishte fshehur. Në vendngjarje u sekuestruan 46.6 kg marijuanë. Në një tjetër operacion u arrestua çift shqiptaresh (burri 31 dhe gruaja 25 vjeçe), pasi në banesë iu gjetën dhe iu sekuestruan 478 gr marijuanë, 12 gr kokainë, 1 peshore, 1 thikë, 3 celularë etj.

DOSSIER

Italia fashiste që kishte pushtuar më parë edhe vetë Shqipërinë po sulmonte tani edhe Greqinë. Për fat të keq, baza nga po niste agresioni ishte Shqipëria, e cila nuk ishte as e pavarur as edhe sovrane



# PASKAL MILO:

## Lufta italo-greke, të dyja shtetet pretendonin se po mbronin shqiptarët

*"Radio 'Athina' u bënte thirrje shqiptarëve të bashkoheshin me ushtrinë greke që të çlironin Shqipërinë nga sundimi italian"*

*"Italia thoshte se Greqia ka kryer politika terroriste kundër popullsisë së Çamërisë dhe tentativa për çregullime kufijsh"*

Fatmira Nikolli

*Rikthimi i zhurmshëm i pa këtës historike problema tike në marrëdhëniet shqiptaro-greke në vëmendjen e opinionit publik dëshmon bindshëm se në thellësinë e ndërgjegjes së një pjese të mirë të shoqërive ballkanike, qofshin këto shqiptare e greke, janë ende të pranishme demonët e urrejtjes nacionaliste.*

*Në dukje të fjetur, mjafton një trazim, qoftë ky edhe i lehtë i ujërave të ndenjura, për t'i zgjuar e për ti vënë ato në lëvizje. Në raste si këto, studiuesit e politikave ndërkombëtare bëjnë thirrje që politika e qeveritë të jenë të vëmendshme - për të parë, se historia nuk është vetëm çështje historianësh, pasi shpesh ajo paracakton edhe politikat, qoftë si tekst, qoftë si pretekst.*

*Këshilla e specialistëve të Marrëdhënieve Ndërkombëtare është që energjitë dhe vullneti të vihen në lëvizje për t'u dhënë zgjidhje shteruese problemeve të së shkuarës e për t'i larguar nga rruga e së ardhmes së përbashkët evropiane të kombeve.*

*Pa njohur të shkuarën nuk mund të ndërtosh të ardhmen, por edhe pa njohur historinë e vërtetë të ngjarjeve të saj nuk mund të orientohesh në të sotmen, që shpesh komplikohet shumë nga paragjykimet e rrënjosura, nga stereotipat, nga mosnjohja e padyshim nga interesa të natyrave të ndryshme.*

*Disa nga çështjet e mprehta që i kanë mbërthyer fortë segmentet e ndjeshme apo edhe të manipuluara të shoqërive në të dyja anët e kufirit e kanë origjinën në luftën italo-greke të viteve 1940 - 1941, që nisi nga toka shqiptare dhe u zhvillua në territorin shqiptar. Si ndihmesë për një kuptim më të mirë të rrjedhojave të kësaj lufte e të ndjeshmërive të kuptueshme të saj, lexuesve, me miratimin e autorit të librit: "Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore" - I, botim i vitit 2014, i prof.dr. Paskal Milo, po u sjellim në vëmendje një pjesë nga kapitulli që merret me luftën italo-greke, studim i mbështetur në një dokumentacion arkivor shumë të gjerë e të dorës së parë e në burime bibliografike nga më të njohurat për këtë temë. Kujtojmë me këtë rast se Milo, përveçse historian, është njohës i mirë i diplomacisë, për shkak të pozicioneve që ka mbajtur në qeveritë shqiptare të viteve më parë. Si nisi lufta italo-greke është vetëm pikënisja e tri pjesëve që hedhin dritë mbi vitet, kur nisi "përplasja" e pazgjidhur ende në ditët tona. Më poshtë, pjesë nga libri i prof.dr.Paskal Milos.*



*Në foto:* **Prof. dr. Paskal Milo**

"Dekreti italian i firmosur nga Verlaci kundër Greqisë? Shqipëria nuk ishte e pavarur, as sovrane"

### FILLIMI I LUFTËS ITALO-GREKE

Rreth orës 3 të mëngjesit të 28 tetorit 1940, kryeministri i Greqisë, Janis Metaksa u zgjua në shtëpinë e tij për një komunikim urgjent të ambasadorit italian Emanuele Graci. Kishte ditë që e priste këtë takim të pazakontë. Diplomati italian me porosi të qeverisë së tij dorëzoi notën-ultimatum në frëngjisht, në të cilën diktatori grek lexoi se Greqia ka thyer neutralitetin e saj në disa raste e në favor të armiqve të Italisë, se ka mbajtur në fuqi garancinë britanike e cila përbënte një program veprimi të drejtuar kundër sigurimit të Italisë, se i ka dhënë fuqisë në luftë me Italinë pozicione të rëndësishme strategjike në territorin grek, se ka kryer veprime provokative kundër kombit shqiptar e ka zhvilluar politika terroriste kundër popullsisë së Çamërisë dhe tentativa të vazhdueshme për të krijuar çrregullime në kufijtë shqiptarë.

Italia, shkruhej më tej në ultimatum, nuk mund të tolerojë, që territori grek është kthyer në një bazë veprimi armiqësor kundër saj, që nuk mund të çojë veçse në një konflikt të cilin qeveria italiane ka gjithë synimin ta evitojë. Për këtë qëllim, vazhdonte ultimatumi, qeveria italiane është e vendosur "t'i kërkojë qeverisë greke si garanci për sigurimin e Italisë, - lirinë për të pushtuar me forcat e saj të armatosura, për kohën sa do të zgjasë konflikti me Britaninë e Madhe, disa pika strategjike në territorin grek".

Qeveria italiane i kërkonte qeverisë greke që të mos e kundërshtonte këtë pushtim e të mos pengonte kalimin e lirë të trupave të destinuara për ta realizuar atë, sepse ai do të ishte i përkohshëm, me karakter thjesht mbrojtës si dhe të jepte urdhrat e duhura që ai të bëhej në mënyrë paqësore. Në rastin kur trupat italiane do të ndeshnin në rezistencë, ultimatumi paralajmëronte se ajo do të mposhtej me armë dhe qeveria greke do të mbante përgjegjësinë e rrjedhojave që do të rridhnin prej saj.

"Atëherë, kjo është luftë" tha Metaksai kur përfundoi së lexuari ultimatumin. Kryeministri grek pyeti se cilat ishin pikat strategjike që Italia donte të pushtonte në Greqi, por pasi nuk mori asnjë sqarim nga Graci përsëriti: "Shikoni pra që është luftë". Janë këto fraza të shkurtra që më vonë u transformuan në "Jo"-në simbolike të Metaksait e që u bë një pikë e fuqishme referimi për rezistencën antifashiste në Greqi. Edhe sikur të kishte bërë lëshime e të kërkonte kompromise, Metaksai nuk do të mund ta shmangte luftën. Ajo ishte e paracaktuar për shkak se edhe objektivat e saj i kapërcenin kufijtë e Greqisë.

Ushtria italiane e rreshtuar në të gjithë gjatësinë e kufirit shqiptaro-grek, rreth 250 km, priste vetëm urdhrin e sulmit. Shtabi i përgjithshëm i ushtrisë italiane i kishte përqendruar forcat në tre sektorë të kufirit që do të ishin edhe tre drejtimet e sulmit. Në sektorin e Korçës ishin vendosur tri divizione të organizuara në korparmatën XXVI me objektivin që të marshonin drejt Follorinës. Ato përbënin krahun e majtë të rreshtimit operacional. Në krahun e djathtë të tij që përfshinte zonën nga bregdeti i detit Jon deri në Vjosë ishin përqendruar tri divizione të tjera, katër regjimente të armëve të ndryshme dhe një batalion milicësh shqiptarë dhe këto të grumbulluara në një korparmatë tjetër. Drejtimi dhe objektivi i sulmit ishte Çamëria deri në Janinë. Divizioni elitar alpin "Julia" që së bashku me dy divizione të tjera komandohej nga vetë Praska ishte rreshtuar në qendër të frontit, midis Ersekës dhe Leskovikut si forca udhëheqëse e operacionit dhe do të marshonte në sektorin e Pindit në pesë kolona me destinacion për të kapur Meçovon, rreth 40 km në lindje të Janinës e që do të ndante më dysh vijën mbrojtëse greke. Pa llogaritur armatimet, burimet italiane flasin për 87 mijë forca të rreshtuara në frontin grek, prej të




*Në foto:*
**Imazhe të luftës italo-greke në Shqipëri**

cilave 55 mijë në Epir, midis të cilave edhe gjashtë batalione shqiptare. Në kufirin me Jugosllavinë ishin lënë 12 mijë forca. Burimet greke japin një numër shumë më të madh forcash.

### SHQIPËRIA, E PUSHTUAR

Përballë forcave italiane, në anën tjetër të kufirit, në Epir, shtabi i ushtrisë greke kishte mobilizuar potencialet më të mira ushtarake greke. Sipas burimeve greke të kohës, raporti i forcave të vendosura në vijën e parë të luftimeve në 28 tetor ishte: 5 divizione greke kundër 10 italiane. Ushtritë e të dy fqinjëve historikë të shqiptarëve ishin bërë gati të kryqëzonin armët, njëri më i madh e më i fuqishëm, Italia fashiste që kishte pushtuar më parë edhe vetë Shqipërinë po sulmonte tani edhe Greqinë. Për fat të keq baza nga po niste agresioni ishte Shqipëria, e cila nuk ishte as e pavarur as edhe sovrane. Formalisht, siç ndodhi edhe më vonë në Greqi, në Jugosllavi, në Norvegji, në Francë e në shtete të tjera evropiane, u krijuan nga pushtuesit regjime e qeveri kuislinge, kolaboracioniste për t'u shërbyer atyre në administrimin e këtyre vendeve. Në Shqipëri kjo kishte ndodhur që në prill 1939.

E drejta ndërkombëtare nuk i kanjohur këto regjime si subjekte të pavarura ndërkombëtare, sepse atyre u ka munguar parimi bazë: vullneti i popullit përmes zgjedhjesh, të lira e të ndershme. Këto regjime u ngritën me ndihmën e hapur të fuqive fashiste dhe me armët e tyre. Shefqet Vërlaci, ministrat, senatorët, anëtarët e Këshillit të Epërm Korporativ Fashist e të tjerë ishin persona që ishin vënë në shërbim të fashizmit dhe vendimet që morën këta njerëz dhe aktet që miratuan ishin antikombëtare.

I tillë ishte dhe dekreti i shpallur në 28 tetor 1940 në emër të Mbretit Viktor Emanueli III nga mëkëmbësi i tij në Tiranë, Jakomoni dhe i firmosur nga kryeministri Shefqet Vërlaci. Ky dekret deklaronte gjendjen e luftës në territoret e prefekturave të Tiranës, Korçës, Vlorës, Elbasanit, Gjirokastrës, Durrësit e Beratit duke iu referuar dekreteve mbretërore të 9 dhe 10 qershorit 1940 për normat dhe zbatimin e ligjit të luftës në tokën e Mbretërisë Shqiptare.

Këshilli i Lartë Fashist Korporativ e aprovoi me unanimitet këtë dekret. Në të njëjtën kohë u shpall edhe dekreti për mobilizimin civil të të gjithë personave që punonin në administratën shtetërore, bashkiake e komunale. Shqiptarët kundër dëshirës e vullnetit të tyre u përfshinë në një luftë që nuk e donin e që nuk ishte në interesin e tyre. Jakomoni kishte dërguar në Romë, raporte në të cilat i kishte paraqitur shqiptarët si entuziastë për luftën kundër Greqisë. Por shumë shpejt, ai dhe shefat e tij do të bindeshin për të kundërtën.

Në 28 tetor, herët në 5:30, ende pa mbaruar afati i ultimatumit që Graci i dorëzoi Metaksait, forcat italiane kapërcyen kufirin shqiptaro-grek. Në ditët e para armiku kryesor i divizioneve italiane nuk ishin trupat greke, të cilat nuk u shfaqën veç në disa raste, por moti shumë i keq, shira të rrëmbyeshme e një mjegull e dendur. Italianët nuk avancuan veç 10-15 km në brendësi të territorit grek, nga bregdeti deri në Pind.

Tërheqja e forcave greke në ditët e para të luftës ishte një lëvizje taktike, që i dha kohë qeverisë për të mobilizuar vendin. Kryekomandantit të ushtrisë greke Aleksandros Papagos as nuk i kishte shkuar ndër mend se përballë forcave të tij do të kishte një ushtri italiane, më të shumtë në numër, por të papërgatitur për luftë e me moral të dobët. Aleate e madhe dhe e paparashikuar për ushtrinë greke ishte edhe koha e keqe e me shira të dendura, që nuk lejoi përdorimin e aviacionit italian në frontin e luftimeve. Forcat greke pasi ndalën avancimin e forcave italiane, në 1 nëntor kaluan në mësymje në sektorin e Kapështicës dhe hynë disa km brenda territorit shqiptar. Në 3 dhe 4 nëntor, Jakomoni njoftonte në Romë se në Epir, në drejtim të Janinës trupat italiane kishin ndeshur në rezistencë të fortë dhe kërkoi urgjentisht mbështetje ajrore e dërgimin e forcave të reja në Korçë. Katër ditë më vonë Mëkëmbësi i Përgjithshëm raportoi se trupat italiane në Epir e në Korçë kishin kaluar në pozita mbrojtëse dhe se nga fronti i luftimeve ishte larguar batalioni shqiptar "Tomorri". Çiano pranoi se iniciativën në front e kishin marrë grekët, por ende ishte optimist, kur shkruan se, "nuk besoj se është koha për të lidhur kokën", se "do të vijë kundërsulmi dhe suksesi, ndofta më shpejtë se sa shpresohet". "Babiloni e plotë", me këto dy fjalë e përshkruante situatën në radhët e forcave italiane në frontin e luftimeve, në 1 nëntor, gjenerali Armelini (Armellini) i Shtabit Madhor të ushtrisë.

Musolinin të zemëruar me gjeneralët e tij dhe i turpëruar në sytë e botës nuk e zinte vendi. E zëvendësoi Viskonti Praskën si komandant të forcave italiane në Shqipëri me Ubaldo Soddu. Në 10 nëntor u tha gjeneralëve në "Palaco Venecia" se "nuk mund të toleroj që në botë të përhapet bindja se nuk kemi qenë të aftë të mundim Greqinë". Numëroi si arsye të dështimeve në front edhe mungesën e revoltës së popullsisë së Çamërisë prapa shpinës së trupave greke siç i kishte premtuar Jakomoni si dhe dezertimin e disa reparteve shqiptare. Me gjithë ndryshimet që bëri në komandën e trupave ushtarake në Shqipëri e përforcimet që dërgoi në front, Musolini nuk e ndali rokullimën e ngjarjeve. Në mesin e nëntorit grekët rifilluan sulmet, veçanërisht në sektorin e Korçës për të pushtuar vetë qytetin, të cilin arritën ta shtinin në dorë në 22 nëntor.

Pushtimi i Korçës ishte një goditje e rëndë në planin operacional për ushtrinë italiane, por akoma edhe më e madhe për prestigjin e saj. Çiano për t'u ngushëlluar shënoi se "humbja e Korçës sigurisht nuk është humbje e Parisit". Musolini përgjegjësitë e disfatave i kërkon vetëm tek gjeneralët e aspak tek vetja. E detyroi Badoljon të dorëhiqet nga shef i shtabit e në vend të tij emëroi gjeneralin Ugo Kavaliero. Por, ofensiva greke nuk u ndal ashtu sikurse edhe tërheqja italiane, tani gjithnjë brenda territorit shqiptar. Në fillim të dhjetorit ranë Gjirokastra, Përmeti, Saranda e Pogradeci. Përgjatë gjithë veprimeve luftarake të forcave greke ato patën ndihmën e vazhdueshme të forcave ajrore britanike që bombardonin pozicionet italiane, anijet dhe objektet ushtarake në portet e Durrësit, Vlorës e Sarandës si dhe qytetet e tjera në Shqipërinë e Mesme e të Jugut. Ato i shkaktuan dëme të mëdha infrastrukturës ushtarake italiane. Pushtimi i këtyre qyteteve shënoi edhe përfundimin e fazës së parë të ofensivës greke.

### THIRRJET E DY SHTETEVE

Logjika e luftës midis forcave e shteteve armike e pranon administrimin e përkohshëm deri në armëpushim ose deri në përfundimin e armiqësive të territoreve të pushtuara. Ushtria greke duke ndjekur ushtrinë italiane në tërheqje, avancoi dhe pushtoi territore shqiptare të Shqipërisë së Jugut. Prania e ushtrisë greke në këto zona ngjalli dyshime te shqiptarët. Ato u shtuan edhe më tepër nga deklarata në radio e Metaksait në 22 nëntor kur mes të tjerash tha se "ne luftojmë jo vetëm për vendin tonë, por gjithashtu për kauzën e popujve të tjerë të Ballkanit dhe për çlirimin e Shqipërisë", por pa përmendur pavarësinë e saj. Radio "Athina" çdo ditë në emisionin e saj në gjuhën shqipe u bënte thirrje shqiptarëve që të bashkoheshin me ushtrinë greke që ishte e angazhuar "të çlirojë Shqipërinë nga sundimi italian".

Autoritetet ushtarake greke organizuan me paragjykime administratën civile lokale në Korçë dhe urdhëruan të pengohet edhe festimi i ditës së pavarësisë shqiptare. Në Gjirokastër në frymën e kësaj politike u krijua "Autoriteti i Vorio Epirit" si trup administrativ civil. Deklarata e Metaksait ngjalli reagime në Romë e Tiranë e u mbajt shënim edhe në Londër. Çiano udhëzoi Jakomonin që Vërlaci e përfaqësues të tjerë të lartë të regjimit t'i përgjigjeshin kryeministrit grek. Qeveritarët kuislingë e kundërshtuan me të drejtë Metaksain, por nga pozita fashiste dhe si avokatë të Italisë fashiste që e kishte pushtuar Shqipërinë.

Rreziku kryesor për Italinë në dhjetor 1940 nuk ishin deklaratat, por ushtria e Metaksait, e cila vazhdonte të përparonte në tri drejtime: në bregdetin jonian shqiptar për të kapur Himarën me destinacion Vlorën, në luginën e Osumit për të pushtuar Beratin dhe drejt luginës së Shkumbinit për të zotëruar Elbasanin me synim për të dalë në Durrës. Ushtria italiane në Shqipëri me gjithë përforcimet gati ishte e paralizuar. Musolini në Romë vetëm shante e mallkonte gjeneralët e shqiptarët që e tradhtuan.

Në gjysmën e dytë të dhjetorit, me gjithë raportimet optimiste të Kavalieros, që zëvendësoi Soddun në krye të trupave italiane në Shqipëri, ofensiva greke nuk u ndal. Në 23 dhjetor forcat greke pushtuan Himarën dhe dolën në Qafën e Llogarasë, duke kërcënuar më tepër se kurrë Vlorën. Avancuan edhe në Këlcyrë duke rrezikuar marrjen e Tepelenës, që përmes luginës së Shushicës synonin të dilnin përsëri në Vlorë.

I ndodhur në një situatë krize të gjithanshme, morale e besimi dhe nën presionin e kritikave të brendshme e në rritje, Musolini ndërmori një akt radikal populist: urdhëroi të gjithë hierarkët e lartë, anëtarë të qeverisë, të Këshillit të Lartë, të partisë të shkonin në front e të luftonin bashkë me trupat. "Vullnetarë me force", shkruan Çiano, i cili edhe vetë u vendos me shtabin e tij në Shqipëri.

***(Vijon nesër)***

**SHQIPTARËT NË LUFTE**

Shqiptarët kundër dëshirës e vullnetit të tyre u përfshinë në një luftë që nuk e donin e që nuk ishte në interesin e tyre. Jakomoni kishte dërguar në Romë raporte në të cilat i kishte paraqitur shqiptarët si entuziastë për luftën kundër Greqisë.

**DEKRETI**

